



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 62 regjistër (JR)
Datë 22.12.2020

Nr. 22 i vendimit
Datë 08.06.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.06.2023, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Artur Gaxha, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 293, datë 10.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet D dhe F të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe neni 49 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit Artur Gaxha, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, i cili pasi kërkoi marrjen e provave të reja, bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, dhe gjykimin në seancë publike, përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 293, datë 10.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe pikën 16 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni.
2. Komisioni administroi raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), dhe kreu procesin e rivlerësimit bazuar në të tria kriteret e kontrollit. Në përfundim, me vendimin nr. 293, datë 10.09.2020, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Gaxha për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
3. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) kundër vendimit të Komisionit. Në ankim, subjekti ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin në detyrë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është i pabazuar në ligj dhe përbën shkelje të normave dhe rregullave ligjore për zhvillimin e një

procesi të rregullt ligjor, por edhe vlerësimin të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara të vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.

5. Për sa u përket aspekteve procedurale, subjekti i rivlerësimit parashton në mënyrë të përmbledhur se:

5.1. Vendimi i Komisionit është rezultat i një hetimi administrativ dhe gjykimi të njëanshëm, kontradiktor, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Vendimi është i paarsyetuar, pasi nuk jep argumente përse nuk janë pranuar provat. Interpretimi i Komisionit për provat është në kundërshtim flagrant me vlerësimin që u është bërë këtyre provave nga ILDKPKI-ja.

5.2. Qëndrimi i Komisionit manifeston njëanshmëri të theksuar, paragjykim, diskriminim, paaftësi dhe keqdashje, pasi nuk jep argumente përse nuk i pranon mandatarkëtimet e kështit të parë të apartamentit ku banon subjekti.

6. Për sa u përket aspekteve të vlerësimit të kriterit të pasurisë, subjekti i fokuson pretendimet e tij të ndara sipas konkluzioneve të Komisionit për secilën pasuri.

6.1. *Për apartamentin e banimit, me sipërfaqe 180 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, konsiderimi i kryerjes së pagesës së kështit të parë [datë 05.10.2010] sipas kontratës së sipërmarrjes nga Komisioni dhe jo sipas mandatarkëtimeve të depozituara prej tij, nuk është i drejtë. Pagesat e kësteve në funksion të kontratës së sipërmarrjes janë kryer në shumat dhe datat e përcaktuara sipas mandateve të depozituara pranë ILDKPKI-së, deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe pranë Komisionit gjatë procesit të hetimit administrativ.*

6.2. *Për të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 210,3 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, mosmarrja në konsideratë e shumës së fituar, lidhur me detyrimin për të paguar tatimin, është konkluzion i padrejtë. Nga dokumentacioni shkresor i depozituar, vërtetohet se të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë edhe ato që lidhen me shumën 137.788 euro, të lindura nga zbatimi i vendimit të datës 10.1.2013, të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK, janë njohur, pranuar dhe paguar nga ana e shoqërisë. Si rrjedhojë, vlera e shitjes së apartamentit në fjalë duhet të përlllogaritet e gjitha si e ardhur në analizën financiare të vitit 2013.*

6.3. *Për ambientin e shërbimit zyrë me sipërfaqe 40 m² dhe garazh, ndodhur në Tiranë, burim krijimi i këtyre pasurive ka shërbyer huaja në vlerën 60.000 USD, e marrë nga z. N. P.. Kjo hua është deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 24.07.2015 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Si e tillë, kjo vlerë duhet të njihet si burim i ligjshëm për krijimin e këtyre pasurive e të përfshihet në analizën financiare të vitit 2005, si e ardhur e ligjshme.*

6.4. *Për apartamentin me sipërfaqe 58,2 m², ndodhur në Golem, Durrës, kështet e tij janë shlyer sipas mandatpagesave dhe sipas datave të nënshkrimit të kontratave respektive.*

6.5. *Për apartamentin me sipërfaqe 72 m², ndodhur në Golem, Durrës, subjekti parashton argumentet e mëposhtme.*

a) Përfundimi i Komisionit se shuma 35.000 euro është paguar e gjitha brenda vitit 2006, nuk qëndron. Mospranimi i pagesës së kështit të parë, me vlerë 25.000 euro nga Komisioni, që ka pasur si burim të ardhurat nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes për apartamentin 58,2 m², është i gabuar dhe i paargumentuar. Balanca negative në rezultatin financiar të vitit 2006, duhet të rishikohet nga Kolegji. Fakti që gjatë vitit 2006 është paguar vetëm shuma 25.000 euro, provohet nga: (i) kontrata e sipërmarrjes nr. {***}, datë 27.06.2006; dhe (ii) deklarimi në DPV-në e vitit 2007. Me kontratën e sipërmarrjes, në nenin 2, provohet pagesa e shumës 25.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, si dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë në shumën 16.000 euro. Deklarimi në DPV-në e vitit 2007 është provë bindëse që 10.000 euro janë paguar gjatë vitit 2008, ndërsa detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese ishte 16.000 euro.

b) Fakti që provon se gjatë vitit 2008 është paguar shuma 11.000 euro, provohet nga: (i) mandatet e depozituara, me vlerë 3.000 euro dhe 5.000 euro; (ii) deklarimi në DPV-në e vitit 2008, si dhe i pakësimit të detyrimit ndaj shoqërisë; (iii) situacioni i punimeve nga shoqëria “{***}” ShPK, që provon se dorëzimi i apartamentit është kryer në fund të vitit 2010, pavarësisht se në kontratën e sipërmarrjes parashikohej të dorëzohej në dhjetor 2006.

6.6. *Për automjetin “Mercedes Benz”, të blerë në vitin 2004 dhe të targuar në vitin 2005,* pagesat për blerjen dhe shpenzimet doganore, janë kryer përgjatë vitit 2004, ashtu si dhe janë deklaruar në deklaratën periodike/vjetore për vitin 2004. Për këtë arsye, shpenzimet e kryera në lidhje me të, duhet të reflektohen në analizën financiare të vitit 2004 dhe jo në atë të vitit 2005.

6.7. *Për automjetin “Mercedes Benz ML550”,* vlera nuk është paguar e gjitha nga subjekti, pasi ishte në bashkëpronësi me znj. A. G.. Subjekti pretendon se nuk kishte detyrim për deklarimin e huasë ose detyrimet e pritshme nga bashkëpronarja, për sa kohë që shuma 15.000 USD, u shlye prej saj [znj. A. G.] *cash* gjithashtu brenda vitit 2011.

6.8. *Automjeti “Toyota Rav4”* është regjistruar në emër të subjektit, por është në pronësi të motrës së tij [L. G.]. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2008, nuk duhet të pasqyrohet vlera 13.489 USD, si shpenzim i kryer për likuidimin e çmimit të blerjes së këtij automjeti.

6.9. *Për të ardhurat nga qiradhëniet, në vitet 2011, 2013, 2014 dhe 2015,* referuar dy shkresave të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 14.07.2020, të ardhurat nga qiradhënia për vitin 2013 dhe vitin 2015 janë më të larta se ato të pasqyruara nga Komisioni në analizën financiare të këtyre viteve dhe, si të tilla, duhet të reflektohen të ndryshuara në Kolegji.

6.10. *Për analizën financiare të vitit 2012:*

a) Duhet të “sistemohen” të ardhurat nga interesat sipas lëvizjeve të llogarisë bankare.

b) Duhet të llogaritet vlera 140.476 lekë, e përfituar si dëmshpërblim shëndeti, dhe kompensimi 25,9 euro, sipas faturës së aeroportit të Vjenës.

c) Shpenzimet duhet të reduktohen si vijon:

- (i) Udhëtimet jashtë vendit janë kryer pranë vëllait të bashkëshortes në Greqi. Vlera e këtyre shpenzimeve duhet të saktësohet nga 1.025.872 lekë në 971.965 lekë, pra 402 euro më pak.
- (ii) Pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 9.000 USD (deklaruar në vitin 2003) dhe 400.000 lekë (pjesërisht nga gjendja e deklaruar në vitet 2006 dhe 2007), e cila është përdorur gjatë vitit 2012 për mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave familjare.
- ç) Të “saktësohet” gjendja e likuiditetit në bankë, nga (-) 1.429.234 lekë në (-) 1.302.857 lekë.

6.11. Në mbështetje të pretendimeve të tij në ankim, subjekti ka paraqitur edhe disa akte¹ të cilat kërkon të pranohen në cilësinë e provës. Në vijim të arsytimit, gjendet analiza e trupit gjykues për sa u përket këtyre akteve.

7. Në datën 31.05.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtrimet e tij në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), përpara seancës së caktuar për shqyrtimin e ankimit. Në këto parashtrime, përpos kërtimeve të parashtruara në ankim, subjekti ka kërkuar për herë të parë ndryshimin e disa zërave në shpenzimet e viteve 2005, 2006, 2008, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

7.1. Në mënyrë të përmbledhur, trupi gjykues i Kolegjit vëren se parashtrimet e subjektit të rivlerësimit konsistojnë kryesisht në kërtime për zbritjen nga zëri i shpenzimeve të jetesës të përqindjes së shpenzimeve që zënë shpenzimet e telefonisë, shpenzimet shëndetësore, arsimit, ushqim/veshmbathje. Po ashtu, në ndryshim nga ankimi, në parashtrime subjekti kërkon aplikimin e një kursi të ndryshëm këmbimi për vlerën 85 mijë USD, tërhequr në vitin 2005. Në ankim, subjekti ka përlllogaritur kursin mesatar të vitit 2005, ndërsa në parashtrime kërkon të zbatohet kursi i ditës – ndonëse vlera e vendosur prej tij është sërish ekuivalenti i kursit mesatar. Së fundmi, subjekti ka kërkuar të zbriten shpenzimet e jetesës për udhëtimet jashtë shtetit, meqenëse për to zbatohen shpenzime shtesë.

7.2. Bashkëngjitur parashtrimeve, subjekti ka paraqitur 18 akte që kërkojnë të pranohen në cilësinë e provës². Ndër to, referuar inventarit, janë analiza financiare për gjithë vitet e

¹ Aktet bashkëngjitur ankimit janë: (i) certifikatë vdekjeje e z. L. H., datë 04.05.2012, nga e cila rezulton se i ndjeri ka qenë kunati i subjektit; (ii) shkresë, datë 18.11.2020, nga Bashkia Tepelenë, në të cilën vërtetohet se motra e subjektit [znj. L. G.] nuk ka aplikuar asnjëherë për t’u pajisur me kartë identiteti dhe pasaportë biometrike; (iii) vërtetim, datë 20.11.2020, nga shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA, ku rezulton se për llogari të subjektit, janë lëshuar polica sigurimi motorike për periudhën korrik 2008 – shtator 2015 dhe për automjetin me targë {***}, nga 11 polica të lëshuara në emër të subjektit, 10 janë si përdorues dhe 1 është si pronar; (iv) deklaratë noteriale, datë 24.11.2020, e motrës së subjektit [znj. L. G.], e cila deklaron se makina është blerë me të ardhurat e saj, por u regjistrua në emër të vëllait meqenëse ajo nuk kishte kartë identiteti shqiptare; (v) udhëzim nr. 1/2012 i DPShTRr; (vi) targë provizore e lëshuar nga autoritetet gjermane, me të cilën ky automjet ka hyrë në territorin e Shqipërisë (foto e targës); (vii) fotografi/filmim video nga pushimet familjare në gusht 2004, ku evidentohet automjeti; (viii) shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave - Dega Durrës, ku për shkak të tejkallimit të afateve të ruajtjes, konfirmohet pamundësia për gjetjen e dokumentacionit të automjetit.

² Aktet e sjella me parashtrimet, përveç analizës financiare për vitet me balancë negative, përfshijnë edhe: (i) mandatpagesa për një apartament të porositur nga motra e subjektit në të njëjtën shoqëri ndërtimi [“{***}”

konstatuara me probleme në analizën e Komisionit, si dhe akte nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të mbështetë pretendimet e tij në ankim për sa i përket mënyrës së kryerjes së pagesave pranë ndërtuesit të apartamentit në Golem, si dhe akte që lidhen me automjetet për të cilat janë konstatuar probleme. Analiza e trupit gjykues për sa u përket këtyre akteve, shtjellohet gjerësisht në vijim.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspekte procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, nëpërmjet të cilit është kryer rivlerësimi i subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit shqyrtohen në Kolegj sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të pikës 2 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar në Komision brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në Kolegj, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Përjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues gjen se plotësohen kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve.

*ShPKJ, në të njëjtën zonë e kompleks me atë të subjektit në Golem, për të vërtetuar se mandatpagesat kanë qenë një praktikë e zakonshme e aplikuar nga shoqëria; (ii) shkresë nga DPSHTR, datë 29.05.2023, që konfirmon pronësinë e automjetit të deklaruar në vitin 2004 dhe targuar në datë 14.07.2005, në pronësi të subjektit; (iii) vërtetim nga DRSHTR-ja, datë 18.08.2022, ku vërtetohet se pronari i mjetit me targë {***}, deri më datë 18.08.2022, nuk është debitor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, gjoha të kontrollit teknik, gjoha të kontrollit në rrugë apo nuk është bllokuar nga organet kompetente të përcaktuara me ligj; (iv) kontratë shitjeje automjeti, që mban datën 22.08.2022, nëpërmjet së cilës subjekti ka blerë nga e afërmja, A. G., pjesën e saj prej 50%, në autoveturën Mercedes Benz; (v) pagesën nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit, për blerjen e automjetit sipas kontratës së shitjes në favor të znj. H. G. (nëna e A. G.); (vi) deklaratat e tatimeve të korrigjuara të deklarimit individual vjetor të të ardhurave (DIVA) nga qiratë, të vitit 2020; (vii) tri mandatpagesa, ndër to dy pa numër dhe një me numër për blerjen e apartamentit në Golem, lëshuar nga shoqëria "{***}" ShPK; (viii) një kasetë e vitit 2004 për evidentimin e targës së automjetit.*

Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 293, datë 10.09.2020, të Komisionit, fillimisht u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.

10.1. Në zbatim të parashikimeve të pikës 1 të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit gjyqësor, Kolegji zbaton një grup dispozitash të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të tij. Së bashku me ankimin, subjekti ka sjellë disa akte, përfshirë një analizë financiare të kryer në vitin 2020, e cila ndodhet në fashikullin e Komisionit, një akt që referon kursin e këmbimit në vitin 2005 dhe një certifikatë vdekjeje të një individi, z. L. H.. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos i marrë ato në cilësinë e provës pasi janë pjesë e fashikullit, si dhe janë të parëndësishme për vendimmarrjen, përpos faktit që nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012³ për aktet që sillen me ankimin.

10.2. Po ashtu, nga verifikimi i procedurës së ndjekur në Komision, rezulton se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat procedurale, ai është njohur me aktet e dosjes, i është dhënë kohë për të paraqitur provat sipas rezultateve të hetimit, si dhe ka paraqitur prova të reja më datë 01.09.2020. Më tej, subjekti nuk paraqiti kërkesa të tjera për akte të reja apo për pamundësi të paraqitjes së tyre deri në atë moment procedural. Për dokumentet e paraqitura në ankim, subjekti nuk ka parashtruar asnjë rrethanë penguese për paraqitjen e tyre në Komision. Edhe dokumenti i paraqitur bashkëlidhur ankimit, që është lëshuar nga organet tatimore, është nxjerrë më datë 10.08.2020, në një kohë kur seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar më datë 04.09.2020, pra tregon se subjekti kishte mundësi ta depozitonte në Komision edhe përpara seancës dëgjimore. Ndërsa dokumentet e paraqitura me shkresën e shoqërisë “{***}” ShPK, përveç kopjes së urdhërpagesës për detyrimin tatimor të mbetur, datë 23.11.2020, dhe kopjes së transfertës bankare për kryerjen e plotë të pagesës së detyrimit të mbetur në shumën 1.712.740, datë 23.11.2020, mbajnë datat deri më 28.08.2020 dhe janë kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit, të cilat subjekti kishte mundësi t’i dorëzonte gjatë hetimit në Komision.

10.3. Trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë në cilësinë e provës aktet e sjella nga subjekti me parashtrimet, si të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, sepse edhe nëse konsiderohen, ato nuk do të ndikonin në marrjen e vendimit⁴. Për sa u përket analizave financiare të periudhave të ndryshme që ka hartuar subjekti, përpos faktit që këto analiza nuk plotësojnë kriteret ligjore për t’u paraqitur në këtë fazë të procesit, trupi gjykues shton edhe që në funksion të vendimmarrjes, ligji ka parashikuar operimin e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit [dhe organeve të tjera të rivlerësimit]. Analiza financiare e kryer në Kolegj, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit përkundër shkaqeve të ankimit, kryhet mbi bazën e akteve dhe sipas

³ Kjo dispozitë parashikon sa vijon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

⁴ Sipas nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

përcaktimeve të nenit 23 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, edhe këto akte, nën dritën e parashikimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” e të njëjtit ligj, u konsideruan të panevojshme.

10.4. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara së bashku me ankimin, si dhe ato të depozituara në Kolegj, bashkëlidhur parashtrimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Mbi shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

- 11.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se vendimi i Komisionit është rezultat i një hetimi administrativ dhe gjykimi të njëanshëm, kontradiktor, i realizuar në kundërshtim të plotë me normat procedurale dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sipas subjektit, vendimi është i paarsyetuar, pasi i mungojnë argumentet për mospranimin e provave. Interpretimi i provave nga Komisioni është në kundërshtim flagrant edhe me vlerësimin që këtyre provave iu është bërë nga ILDKPKI-ja. Qëndrimi i Komisionit manifeston njëanshmëri të theksuar, paragjykim, diskriminim, paaftësi dhe keqdashje, pasi nuk jep argumente përse nuk i pranon mandatarkëtimet e kështit të parë të apartamentit ku banon subjekti.

11.1. Kolegji i mori në shqyrtim pretendimet e subjektit nën dritën e dispozitave që rregullojnë ankimin në procesin e rivlerësimit, sikurse edhe të dispozitave kushtetuese që rregullojnë procesin e rregullt, përfshirë nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”). Nga shqyrtimi i akteve në dosje, trupi gjykues së pari sjell në vëmendje se përpos argumenteve të përgjithshme, subjekti i rivlerësimit nuk ka ilustruar asnjë rrethanë konkrete faktike që do të cilësohej edhe teorikisht si bazë për të treguar indicie paragjykimi apo keqdashjeje e diskriminimi të ndonjë forme. Në këto kushte, analiza e këtyre pretendimeve mund të kryhet vetëm në nivel teorik të të drejtave kushtetuese për proces të rregullt. Edhe nga ky këndvështrim, trupi gjykues nuk konstaton veprime apo sjellje procedurale të Komisionit, të cilat të kenë përbërë shkelje të të drejtave të subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt. Komisioni ka komunikuar rregullisht me subjektin dhe, referuar paragrafit 21.1 të vendimit, i ka dhënë gjithë kohën e nevojshme për t’u mbrojtur e paraqitur provat e tij. Ky fakt nuk është kontestuar nga subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore në Komision apo në ndonjë rast tjetër. Rezulton po ashtu nga kronologjia, që ndonëse rezultatet e hetimit paraprak i janë njoftuar subjektit që në datën 17.06.2020, ai është njohur me aktet e dosjes më 22.06.2020 dhe iu mundësua kohë për paraqitjen e parashtrimeve deri më 01.09.2020, pra mbi dy muaj. Ndërkohë, subjekti është njoftuar për seancën gjyqësore që do të zhvillohej më 04.09.2020 që në datën 21.07.2020. Të gjitha këto aspekte të kronologjisë së veprimeve të kryera në procesin e rivlerësimit, dëshmojnë kohë të mjaftueshme për subjektin për t’u përgatitur e për të ushtruar të drejtat e tij kushtetuese. Subjekti po ashtu është njohur me aktet në fashikull dhe ka sjellë

provat e aktet që ka zgjedhur në fazën përkatëse të procesit. Nga kjo analizë, rezulton se pretendimet e subjektit për qëndrime paragjyquese nga Komisioni, janë të pabazuara.

11.2. Fakti që Komisioni ka vlerësuar provat ndryshe, nuk mund të argumentohet se përbën provë të keqdashjes apo diskriminimit. Siç është arsyetuar edhe në çështje të tjera të shqyrtuara nga Kolegji⁵, Komisioni gëzon diskrecion ligjor për vlerësimin e provave dhe është në përputhje me çfarë ka arsyetuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) në jurisprudencën e saj⁶. Më tej, nuk është konstatuar dhe as subjekti nuk ilustron ndonjë rrethanë faktike që mund të përbëjë bazë për të vënë në pikëpyetje paanësinë e komisionerëve, apo ndonjë cilësi personale të vetë subjektit, përcaktuar nga neni 18 i Kushtetutës⁷, mbi bazën e së cilës ai është ndjerë i diskriminuar. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për paragjykim, keqdashje apo diskriminim nga Komisioni gjatë procesit të hetimit administrativ apo nëpërmjet vendimit të marrë, rezultojnë të pabazuara në ligj, përveçse të pambështetura në fakte. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për aspekte të tjera të procesit të rregullt u trajtuan sipas jurisprudencës së Kolegjit, në përputhje edhe me vendimin e GjEDNj-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*. Nga aktet në dosje, Kolegji nuk konstatoi situatë nga e cila të rezultojë se Komisioni ka cenuar elementet e gjykimit nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji nr. 49/2012.

11.3. Edhe pretendimi se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, kontradiktor dhe nuk plotëson nivelin kushtetues, rezulton i paargumentuar në detaje konkrete. Në këto kushte, trupi gjykues e analizoi atë në nivel parimor, sipas parashikimeve të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Sipas pikës 4⁸ të kësaj dispozite, me fokus pjesën përshkruese-arsyetuese, rezulton se vendimi objekt ankimi përmban të gjitha elementet e përcaktuara shprehimisht nga ligji e konkretisht, rrethanat e çështjes dhe konkluzionet e trupit gjykues, provat dhe arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi, rekomandimin e relatorit/relatores, sikurse edhe dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. Gjykata Kushtetuese ka theksuar në jurisprudencën e saj⁹ se argumentet

⁵ *Shih arsyetimin e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit I. Milkurti [JR nr. 8/2021], si dhe në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit E. Beci [JR nr. 4/2021].*

⁶ *Ndër të tjerë, vendimi García Ruiz kundër Spanjës, ku gjykata ka konkluduar se pranueshmëria dhe vlerësimi i provave mbi themelin në përgjithësi janë kompetencë vetëm e gjykatave kombëtare, të cilat duhet të peshojnë elementet e mbledhura prej tyre dhe se pranueshmëria e provave dhe vlerësimi i tyre në parim janë kompetencë e së drejtës së brendshme dhe gjykatave kombëtare. Shih edhe udhëzuesin e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil):*

https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQL.pdf [GC].

⁷ *Neni 18 i Kushtetutës, në pikat 2 dhe 3 parashikon cilësitë e mbrojtura nga diskriminimi si vijon: “2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive [...]”.*

⁸ *Neni 57, pika 4 përcakton: “[...] 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi [...]”.*

⁹ *Shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 19, datë 01.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese.*

e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Në vendimin e Komisionit, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, për cilëndo nga pasuritë e hetuara, janë përmbushur të gjitha urdhërimet ligjore të sipërcituara, përfshirë edhe dispozita përkatëse ku është bazuar konkluzioni i Komisionit për secilin rast. Nga aktet në fashikull, pjesërisht cituar edhe më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pas përmbylljes së hetimit administrativ, Komisioni u ka dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të normave ligjore që lidhen me të provuarit për gjendjen e fakteve dhe rrethanat e çështjes, me vendim përfundimtar të arsyetuar, referuar dispozitave materiale të ligjit nr. 84/2016. Gjatë gjithë atij procesi, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë argumentuar apo parashtruar në ndonjë fazë veprime që përbëjnë ndonjë cenim të të drejtave të tij procedurale, përfshirë ato për të paraqitur shpjegime, pretendime dhe prova. Ky pretendim me referencë procesin e rregullt rezulton të jetë ngritur për herë të parë në ankim.

11.4. Po ashtu, në jurisprudencën e saj, GjEDNj-ja ka arsyetuar se ndërsa neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së i detyron gjykatat të japin vendime të arsyetuara, kjo nuk duhet të kuptohet si detyrim për të dhënë përgjigje të detajuara për çdo argument, për sa kohë pretendimet kryesore të palëve janë trajtuar¹⁰. Siç është shtjelluar më sipër, pretendimi i subjektit për problematika me vendimin e Komisionit me natyrë mungese arsyetimi apo sepse paraqet njëanshmëri e paragjykime, nga kjo analizë e kryer nën dritën e dispozitave ligjore dhe standardeve të vendosura e zhvilluara nga GjEDNj-ja mbi bazën e nenit 6 të Konventës, rezulton i pabazuar dhe lidhet me vlerësimin që Komisioni u ka bërë shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në raport me faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ.

11.5. Kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit garanton që ushtrimi i funksioneve nga institucionet e rivlerësimit të bëhet mbi bazën e pavarësisë, paanësisë, barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor¹¹. Në kushtet kur subjekti nuk ka evidentuar asnjë situatë që mund të argumentohet se përbën njëanshmëri apo të ketë parashtruar rrethana për të pasur indicie për paragjykim, diskriminim apo keqdashje, duke pasur parasysh edhe faktin që këto pretendime ngrihen për herë të parë e pa asnjë ilustrim faktik në ankim, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se pretendimet janë të pabazuara dhe janë përpjekje për të kontestuar vendimmarrjen në themel të Komisionit, nëpërmjet cilësimeve me natyrë procedurale.

11.6. Për sa më lart, Kolegji konkludon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenimin e procesit të rregullt ligjor, përveçse lidhen me mënyrën e shqyrtimit të provave, nuk pasqyrojnë në thelb elemente të tilla nga të cilat mund të evidentohet se Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Për rrjedhojë, këto pretendime u vlerësuan të pabazuara.

¹⁰ Përkatësisht, në *Van de Hurk kundër Holandës*, paragrafi 61, dhe *Buzescu kundër Rumanisë*.

¹¹ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021.*

C. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. Mbështetur në aktet shkresore administruar në dosjen gjyqësore, në përgjigje të shkaqeve ankimore parashtruar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, trupi gjykues kreu kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion, siç shtjellohet edhe më poshtë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që ankimi i subjektit të rivlerësimit ishte i papabazuar, ndërsa vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi. Më poshtë, arsyetimi i Kolegjit ndjek radhën e shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti.

*I. Apartamenti me sipërfaqe 180 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*

13. Për këtë pasuri, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, në vlerën (-) 7.868.788 lekë, për të justifikuar pagesën e këstit të parë për blerjen e tij, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për periudhën 1.1.2010 – 5.10.2010. Komisioni ka vlerësuar se kësti i parë prej 60.000 eurosh është shlyer në kohën dhe mënyrën e përcaktuar në kontratën noteriale të sipërmarrjes, më datë 05.10.2010, dhe jo sipas disa mandatpagesave të depozituara nga subjekti në vitin 2017 dhe dinamikës së veprimeve të referuara në një “Deklaratë mirëbesimi” mes tij dhe ndërtuesit që mban datën 20.01.2015, sipas së cilës kalendari i pagesave ishte i ndryshëm nga sa parashikohej në kontratën noteriale të sipërmarrjes.

13.1. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton si të padrejtë përfundimin e Komisionit për të konsideruar datën 05.10.2010, si datë të kryerjes së pagesës së këstit të parë, dhe jo shlyerjen sipas mandatarkëtimeve të depozituara prej tij. Ai kërkon që pagesat të përllogariten të kryera në vlerat dhe kohën e përcaktuar në mandatpagesat e depozituara në vitin 2015 në ILDKPKI, e që më pas i janë bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*. Sipas këtij kalendari, pagesat kanë ndodhur më tej në kohë, pasi subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e një apartamenti [analizuar gjerësisht më poshtë në rubrikën e numërtuar “V”] në Golem. Këto të ardhura, sipas subjektit, kanë shërbyer si burim për shlyerjen e 60.000 eurove pagesë në vitin 2010 për këtë pasuri.

13.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi në tërësi të gjitha aspektet e kontrollit të pasurisë së kryer nga Komisioni, konkludoi që edhe nëse pranohej kalendari i pagesave i pretenduar nga subjekti, ai gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe pasuritë e krijuara. Siç arsyetohet gjerësisht më tej në vendim, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë fillestare [apartament në Golem], nga shitja e së cilës pretendon të jetë fituar shuma që ka shërbyer si burim për shlyerjen e këstit të parë të apartamentit objekt analize në vitin 2010. Për pasojë, edhe në variantin e analizës financiare sipas kalendarit të potencuar nga subjekti nëpërmjet mandatpagesave të depozituara në vitin 2015 në ILDKPKI, krijimi i kësaj pasurie mbetet me problematika të mungesës së burimeve të ligjshme. Arsyetimi i trupit gjykues shtjellohet në vijim.

13.3. Nga dokumentacioni në fashikull rezulton se:

a. Në deklaratën periodike për vitin 2010, subjekti ka deklaruar kontratën noteriale të sipërmarrjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.10.2010] me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit në fjalë, në vlerën prej 200.000 eurosh. Po aty, subjekti ka deklaruar se vlera e paguar për vitin deklarues ishte 60.000 euro, pa specifikuar burimin e të ardhurave për pagesën. Në deklaratat e viteve në vijim, subjekti ka deklaruar përkatësisht shlyerjen e shumës prej 120.000 eurosh në vitin 2011 dhe detyrimin e mbetur ndërtuesit në vlerën prej 20.000 eurosh.

b. Në deklaratën periodike për vitin 2015, subjekti ka deklaruar fitimin e pronësisë së kësaj pasurie, sikurse edhe shlyerjen e detyrimit prej 20.000 eurosh. Burim për shlyerjen e kësaj vlere është deklaruar një llogari e mbyllur në Bankën Intesa SanPaolo.

c. Në aktet e administruara nga Komisioni, kanë rezultuar dy kontrata sipërmarrjeje – depozituar përkatësisht nga subjekti në ILDKPKI dhe në ZVRPP Tiranë që ndonëse mbajnë të njëjtat kredenciale [numër repertori e koleksioni, përpara së njëjtës notere, në të njëjtën datë] dhe kanë të njëjtin objekt, nuk janë identike. Dallimi mes tyre qëndron te çmimi për metër katror dhe kalendari i pagesave. Konkretisht, kontrata e depozituar në ILDKPKI referon çmimin 1.111 euro/m², në total vlera prej 200.000 eurosh (njësoj me kontratën tjetër), dhe kryerjen e pagesave si vijon: 30% e vlerës, ose 60.000 euro, “në momentin e nënshkrimit të kontratës”. Pjesa tjetër e vlerës referohet që do të paguhet me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit. Nga ana tjetër, kontrata e depozituar në ZVRPP, ndonëse ka të njëjtin çmim në total, citon 1.000 euro/m² dhe kalendar pagesash si vijon: 30% të vlerës, ose 60.000 euro, “në momentin e nënshkrimit”, 50% të vlerës, ose 100.000 euro, me kredi bankare në llogarinë e sipërmarrësit deri në tetor 2010 dhe pjesa e mbetur, afërsisht 20% e vlerës, ose 40.000 euro, në momentin e dorëzimit fizik nga sipërmarrësi, në shtator 2011. Kontrata me këtë kalendar pagesash është konfirmuar nga noterja përpara së cilës është hartuar¹².

ç. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka informuar ILDKPKI-në për nënshkrimin e një kontrate porosie nga subjekti në datën 05.10.2010, me vlerë 200.000 euro¹³. Po ashtu, sipas informacionit në e-mail-in bashkëlidhur kësaj shkrese, që përcjell raportimin e shoqërisë ndërtuese [“{***}” ShPK], konfirmohet kontrata e porosisë së apartamentit. Së fundmi, noterja [D. K.] ka raportuar blerjen e këtij apartamenti më 23.01.2015, nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes. Në këtë kontratë, palët kanë specifikuar që: “Pagesa është kryer me bankë në periudha të ndryshme deri në likuidimin total të saj. Pagesat kanë filluar që në datën 06.10.2010”.

d. Sipas kontratës së shitblerjes së sipërcituar [datë 23.01.2015], palët konfirmojnë që çmimi është likuiduar plotësisht ndër vite, “referuar kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.10.2010”.

dh. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më 24.07.2015, në përgjigje të kërkesës së inspektore për të paraqitur dokumentacionin ligjor që vërteton pagesën prej 60.000 eurosh, deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010 dhe burimin për shlyerjen e pagesave

¹² Notere D. K. - Kthim përgjigje Komisionit, më 10.12.2019.

¹³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.05.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar *kreditë bankare* prej 120.000 eurosh nga Banka Raiffeisen.

e. Në ILDKPKI [si dokumentacion mbështetës të deklaratës së pasurisë për rivlerësimin], subjekti ka depozituar një “Deklaratë mirëbesimi mes palëve”, që mban datën 20.01.2015, hartuar në zyrat e shoqërisë ndërtuese mes subjektit dhe administratorit/ortakut të vetëm të shoqërisë. Sipas kësaj deklarate, palët parashtrojnë një kalendar pagesash të ndryshëm nga secili prej dy versioneve të kontratave të sipërmarrjes, cituar në nënparagrafin “c” më sipër. Për të provuar këtë kalendar të ndryshëm, subjekti ka dorëzuar tri mandatpagesa, sipas të cilave mënyra e shlyerjes së detyrimit ndërtuesit ishte si vijon: shuma prej 30.000 eurosh, paguar më 10.11.2010, shuma e dytë prej 30.000 eurosh, paguar më 06.12.2010 dhe shuma prej 20.000 eurosh, paguar më 25.09.2015. Subjekti po ashtu ka depozituar akte nga Raiffeisen Bank, nëpërmjet të cilave konfirmohet kalimi i vlerës prej 120.000 eurosh nga personi i lidhur/bashkëshortja të shoqëria “{***}” ShPK, në datën 11.02.2011, me përshkrimin “blerje apartamenti sipas kontratës së kredisë nr. rep. {***}, nr. kol. {***}”.

13.4. Nga aktet e sipërcituara, rezulton që subjekti ka paraqitur të paktën pesë (5) kalendarë/mënyra të ndryshme kohore¹⁴ për kryerjen e pagesave të pasurisë në fjalë, që janë depozituar në momente të ndryshme dhe në institucione të ndryshme. Përkatësisht, subjekti ka paraqitur dy (2) kalendarë të ndryshëm pagesash në të njëjtën kontratë sipërmarrjeje në dy institucione të ndryshme; një (1) kalendar tjetër [të tretë] pagesash në vitin 2015, sipas “Deklaratës së mirëbesimit” me ndërtuesin, dhe mandatpagesat në funksion të atij kalendari; një (1) kalendar pagesash [të katërt] në kontratën e shitjes [e cila referon kontratën e sipërmarrjes, ndonëse kjo e fundit rezulton me dy kalendarë], si dhe një variant tjetër [të pestë] në korrik 2015, pyetur nga ILDKPKI-ja. Sipas këtij kalendari, pagesa e 60.000 eurove kishte për burim kreditë. Po ashtu, pavarësisht nga ndryshimet në kalendarin e pagesave për periudhën e mëpasme, të dyja kontratat e sipërmarrjes *shprehimisht* referojnë që subjekti ka paguar 60.000 euro “*në momentin e hartimit të kontratës së sipërmarrjes*”, që nënkupton datën 05.10.2010. Edhe në kontratën e shitjes, subjekti ka pranuar që pagesa e parë ka ndodhur të nesërmen e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, ndonëse mandatpagesat dhe “deklarata e mirëbesimit” datojnë vetëm tri (3) ditë përpara kontratës së shitjes. Për rrjedhojë, është e pakuptimtë përse palët zgjodhën të referojnë kontratën e sipërmarrjes dhe jo mandatpagesat dhe “deklaratën e mirëbesimit” nëse situata faktike ishte ajo e përshkruar në këtë të fundit.

13.5. Komisioni ka vendosur të pranojë kushtet e pagesës sipas kontratës, si versioni më i logjikshëm, për shkak të problematikave të sipërpërshkruara. “Deklarata e mirëbesimit”

¹⁴ Nga dokumentacioni i administruar për regjistrimin e pronës nga ZVRPP-ja, evidentohet një shkresë e shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet së cilës administratori i saj njofton këtë institucion se mandatet e dërguara me shkresën e noteres, i përkasin një kontrate sipërmarrjeje me porosinë tjetër, dhe në konsideratë duhet të merren mandatpagesat e datave 21 dhe 22 janar 2015 pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Banka Kombëtare Tregtare, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, ka konfirmuar se më datë 21 dhe 22 janar 2015, janë kryer dy depozitime cash nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, për llogari të Artur Gaxha, me vlerë 40.000 euro secili, me përshkrim: “likuidim kësti për apartamentin në rrugën “{***}”” dhe “likuidim kësti për blerje shtëpie”.

[hartuar në ambientet e shoqërisë ndërtuese] bie ndesh me kontratën e shitjes, hartuar përpara noteres, pasi vërtetësia e përcaktimeve të njërës përjashton vërtetësinë e tjetrës. Po ashtu, në korrik 2015, i pyetur në mënyrë specifike në ILDKPKI, për dokumentacion ligjor për *pagesën e kësteve dhe burimin*, subjekti ka referuar si burim krijimi të kësaj pasurie vetëm një kredi në vlerën 120.000 euro në Raiffeisen Bank¹⁵. Duke abstraguar nga fakti që si burim shlyerjeje detyrimesh në atë moment, subjekti ka deklaruar një kredi të cilën në kohën e transaksioneve objekt kontrolli që datojnë fundvitin 2010 nuk e kishte marrë ende, nga ky akt deduktohet që nëse subjekti do të kishte në disponim burime të tjera, konkretisht ato nga shitja e apartamentit në Golem, ato do të duhet të kishin gjetur pasqyrim në këtë dokument zyrtar të kohës. Përkundrazi, subjekti ka deklaruar si burim një kredi që në momentin e shlyerjes, nuk e kishte marrë ende, ndërsa dinamika e pagesave sipas mandatarkëtimeve dhe dakordësia nëpërmjet “deklaratës së mirëbesimit” nuk është parashtruar as në atë moment kohor, në korrik 2015, gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, ndonëse në distancë kohore vetëm gjashtë- (6-) mujore prej veprimeve të pretenduara në janar të të njëjtit vit. Me fjalë të tjera, edhe nën dritën e këtyre pohimeve nën përgjegjësi të subjektit, nëse “Deklarata e mirëbesimit” ekzistonte vërtet më 20.01.2015, nuk kishte arsye përse subjekti të mos i referohej as në deklaratimet në ILDKPKI, në korrik 2015, dhe as në kontratën e shitjes në shtator 2015.

13.6. Nga ana tjetër, aktet e tjera në fashikull, të përcjella nga BKT-ja dhe ZVRPP-ja, tregojnë që kalendari sipas mandatpagesave, nuk konfirmohet nga sa rezulton në bankë, dhe është kundërshtuar edhe nga ndërtuesi në korrespondencë me ZVRPP-në. Konkretisht, dhe siç referohet edhe në vendimin e Komisionit¹⁶, BKT-ja ka konfirmuar¹⁷ se derdhjet e referuara në mandatpagesa nuk rezultojnë të kenë ndodhur, ndërsa në ZVRPP ndërtuesi ka referuar që mandatpagesat i përkasin një objekti, kontrate dhe porositësi të *ndryshëm* nga subjekti. Fakti që në maj 2020, me rezultatet e hetimit, subjekti ka sjellë një vërtetim tjetër pagesash në BKT nga ndërtuesi, përforcon bindjen që ka një mospërputhje serioze mes sa pretendon subjekti, kundrejt sa kanë pranuar palët në kontratë, apo edhe sa parashtrajnë palët në momente të ndryshme, në instanca të ndryshme.

13.7. Trupi gjykues i Kolegjit kreu një analizë të detajuar dhe të integruar të gjithë aspekteve të pasurisë, në funksion të një vlerësimi rigoroz e në përputhje me jurisprudencën e tij të deritanishme. Nga kjo analizë, rezultoi së pari, që mandatarkëtimet e përcjella nga subjekti me deklaratën e pasurisë [*vetting*], paraqiten në përputhje me elementet e formës, sipas ligjeve që rregullojnë kontabilitetin¹⁸. Së dyti, nëse abstragohet nga problematika që ato paraqesin për

¹⁵ Faqe 5, përgjigje e pyetjes 15, procesverbali i mbajtur në ILDKPKI më 24.07.2015, nënshkruar nga subjekti, pasqyruar si vijon: “Ju paraqes kontratën e sipërmarrjes nr. [...], datë 05.10.2010. Si burim financiar për të shlyer apartamentin, do të merrim dhe morëm në vitin 2011 kredi në shumën 120.000 euro në RFB”.

¹⁶ Fundi i faqes 14, “Analiza e pagesave të kryera dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie”, në <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-Artur-Gaxha.pdf>.

¹⁷ Shkresa nr. prot. {***}, dërguar Komisionit më 17.01.2020.

¹⁸ Sipas nenit 9 të ligjit nr. 7661/1993 “Për kontabilitetin”, i cili parashikon, ndër të tjera, referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”, se dokumenti mandatarkëtimi “[...] përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë: a) emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën; b) emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes; c)

nga përmbajtja, me kontradiktat e analizuara më sipër, në një qëndrim garantist të Kolegjit, ku pranohen pagesat sipas kalendarit të parashikuar në to, si dhe pas korrektimit të të ardhurave nga shitja e makinës në vitin 2010, të deklaruara si burim i përdorur për këtë pagesë, subjekti rezulton me mundësi financiare për të kryer pagesën e këstit të parë. Nga ana tjetër, rezulton që edhe në këtë qasje tejet garantiste të Kolegjit, mungesa e burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë e analizuar në këtë rubrikë të arsytimit, shitja e së cilës është pretenduar si burim i të ardhurave të përdorura për shlyerjen e këstit të parë, nuk do të ndryshonte gjendjen në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në vitin 2006. Për pasojë, edhe në këtë qasje të ndërmarrë, konkluzioni i Komisionit në pikën fundore për këtë pasuri, është i bazuar.

13.8. Pasi Komisioni ka konsideruar se pagesa e vlerës prej 60.000 eurosh për pasurinë objekt analize është kryer në datën 05.10.2010, nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit se një pjesë e vlerës vjen nga të ardhurat nga shitja e një apartamenti në Golem në nëntor 2010, në vlerën prej 41.000 eurosh. Subjekti kundërshton këtë konkluzion të Komisionit duke referuar në mbështetje një revokim të një kontrate sipërmarrjeje që mban datën 04.11.2010. Kontrata e sipërmarrjes i përket datës 27.06.2006. Sipas subjektit, apartamenti i është kthyer shoqërisë ndërtuese, ndërsa ai ka marrë mbrapsht shumën prej 41.000 eurosh në datën e revokimit, 04.11.2010. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me apartamentin e porositur në Golem, zanafillë e krijimit të këstit të parë të kësaj pasurie, shtjellohet në vijim në paragrafët përkatës.

- 14.** Burimi tjetër i deklaruar për shlyerjen e pagesës prej 60.000 eurosh, analizuar nga Komisioni, është gjendja e likuiditeteve jashtë sistemit bankar, në vlerën prej 9.000 USD, për të cilat subjekti ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga emigracioni nga dy vëllezërit. Komisioni nuk ka pranuar kërkesën e subjektit për të përfshirë në analizë edhe të ardhurat e vëllait nga punësimi në Shqipëri në periudhën kohore 2001-2003, sikurse as pretendimet për përfshirjen në analizë të kursimeve familjare të tij [subjektit], në kushtet që në deklaratën fillestare, burim i deklaruar kanë qenë vetëm të ardhurat nga emigracioni. Në konkluzion, Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni nuk u provuan, sikurse nuk u provuan as dhuratat e dhëna prej tyre, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Përfundimisht, pasi ka kryer një analizë financiare për vitin 2006 për subjektin, Komisioni konstatoi balancë negative.

14.1. Në ankim, subjekti kundërshton: (i) mospranimin e vlerës prej 9.000 USD, të deklaruar si burim nga kursime familjare në vitin 2003, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit; (ii) mospranimin në përlllogaritje nga Komisioni të gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2006, me vlerë 600.000 lekë dhe atë të deklaruar në vitin 2007, me vlerë 300.000 lekë, kundrejt mundësisë së përballimit të pagesave me burime të ligjshme.

tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimt, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare; ç) përshkrimin e përmbajtjes së treguesve sasiore dhe vlerorë; d) veprimet për shitjen e sendeve, furniturat, punimet dhe shërbimet e kryera për një veprimtari ekonomike, profesionale apo administrative dokumentohen në çdo rast me faturë”.

14.2. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në funksion të kontrollit të vendimit objekt ankimi, rezulton se subjekti ka pasur burime financiare të mjaftueshme nga të ardhurat e tij për t'i krijuar kursimet në shumën prej 9.000 USD, e deklaruar si *cash*, pavarësisht nga të ardhurat e vëllait nga emigracioni. Nga ana tjetër, edhe nëse kryhet korrektim duke përlogaritur vetëm të ardhurat e subjektit duke abstraguuar nga shpjegimet e tij kontradiktore në momente të ndryshme kohore [shih në vijim], efekti financiar në shlyerjen e këtij kësti nuk ndryshon rezultatin përfundimtar për mungesë burimesh. Në vijim, arsyetimi i Kolegjit, fokusuar në hapat e ndërmarrë në funksion të këtij konkluzioni.

14.3. Trupi gjykues vëren që subjekti ka qenë kontradiktor për burimet e deklaruara për këto likuiditete. Në deklaratën *fillestare* të pasurisë, për vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar likuiditete *cash*, në shumën 9.000 USD, “nga të ardhurat nga puna në emigracion e vëllezërve të tij”. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI më datë 24.7.2015, subjekti është shprehur se kursimet dhe gjendja *cash* kanë si burim edhe kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, përpos ndihmës nga vëllezërit e subjektit nga puna në emigracion. Nga ana tjetër, dhe ndryshe nga sa ka deklaruar në vitet 2003 dhe 2015, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se shuma e deklaruar përbën *kryesisht kursime* në vite të familjes, ndërsa dhurata e vëllezërve emigrantë, është afërsisht vlera 400.000 dhrahmi, e cila është depozituar prej bashkëshortes në bankë në vitin 1998. Për të mbështetur pretendimin se vlera e deklaruar *cash*, prej 9.000 USD, nuk është e gjitha kontribut i vëllezërve të tij, në Komision subjekti ka depozituar një nxjerrje llogarie të bashkëshortes së tij të vitit 1998 në bankën NBG, nga e cila rezulton depozitë në vlerën 390.500 dhrahmi greke në datën 27.10.1998.

14.4. Për të ardhurat e vëllezërve nga emigracioni, subjekti pretendon se dokumentacioni justifikues mungon për shkak të kohës që ka kaluar. Si provë për të ardhurat e njërit prej vëllezërve, subjekti ka depozituar një “dëshmi me betim” të datës 21.11.2018¹⁹. Deklaruesi shprehet se vëllai i subjektit ka jetuar dhe banuar në Farsala nga viti 1991 deri në vitin 1996, dhe punonte në punë të ndryshme²⁰. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në Komision, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të tij dhe personave të lidhur për periudhën kohore deri në shkurt 2004, të përfshihen edhe të ardhurat e vëllait meqenëse deri më datë 24.02.2004, ai ka qenë pjesë e trungut familjar të subjektit²¹. Subjekti ka depozituar edhe një dokument të datës 30.10.2019 nga Alpha Bank, në të cilën vërtetohet se z. G. G. i ka kaluar paga nga “{***}” (ish-{***}), për periudhën 2001 – 2003, në vlerën 1.609.294 lekë.

14.5. Në Kolegj u krye analiza financiare për të kontrolluar mundësinë e krijimit të këtyre të ardhurave, në linjë me mënyrën se si ka proceduar Komisioni. Nga kjo analizë, bazuar në aktet në fashikull, rezultoi se subjekti i rivlerësimit mbulon shumën e deklaruar në vitin 2003 me

¹⁹ Hartuar në Gjykatën e Paqit, Farsala, Greqi, nga një shtetas grek.

²⁰ Për vëllanë tjetër, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhura të krijuara në emigracion.

²¹ Referuar certifikatës familjare, rezulton se subjekti ka qenë në një trung familjar me vëllain e tij G. G. dhe më datë 25.02.2004, është kryer ndarja familjare.

burime të ligjshme, pavarësisht nga kursimet e deklaruara prej tij me burim nga punësimi i vëllezërve në emigracion. Pavarësisht nga ky korrektim, balanca pozitive e përftuar nuk është e tillë që të ndryshojë rezultatin përfundimtar, siç shtjellohet në këtë arsyetim më sipër dhe në vijim.

14.6. Subjekti ka deklaruar kursime në *cash* në deklaratat periodike për vitet 2006 dhe 2007, përkatësisht në vlerat 600.000 lekë dhe 300.000 lekë. Komisioni ka konstatuar pamundësi të krijimit të gjendjes *cash* për shkak të balancës negative të vitit 2006, ndërsa për vitin 2007, ndonëse me balancë pozitive, u gjend në pamundësi për përdorimin e këtij likuiditeti, meqenëse në vitin 2009 subjekti i ka përdorur ato për depozitat në emër të fëmijëve [në total 3.400 euro]. Subjekti konteston të dyja këto konkluzione në ankim. Për vitin 2006, subjekti kërkon që në analizë të mos përfshihen shpenzime mobilimi apartamenti në vlerën 1.500.000 lekë, shpenzimet për telefoni celulare, sikurse edhe të përfshihen të ardhurat nga shitja e apartamentit në Golem [analizuar më vijim] dhe të korrektohen kurset e këmbimit në vlerën 172.214 lekë. Për sa i përket përdorimit të kursimeve të deklaruara për vitin 2007 kundrejt depozitave në 2009, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit është i gabuar, pasi depozitat janë krijuar nga dhurata të ndryshme për fëmijët që prej lindjes, siç ka deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2009. Ky vit, sipas analizës së Komisionit, rezulton me balancë pozitive, gjë që konfirmon se përdorimi i kursimeve të mëparshme ka qenë i panevojshëm.

14.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet kur nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, subjekti rezulton me balancë negative fondesh në vitin 2006 [shih në vijim], është i pabazuar pretendimi i subjektit për përlllogaritje kursimesh të vitit kundrejt këstit të parë të apartamentit objekt analize. Për sa u përket kursimeve të deklaruara në vitin 2007, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit qëndron. Në kushtet kur subjekti, qoftë në vitin 2007, ashtu edhe në vitin 2009, në analizën e kryer në Komision rezulton me mundësi financiare për të krijuar kursimet e deklaruara me burime të ligjshme, edhe duke abstraguuar nga pretendimet për dhurime për fëmijët nga lindja, si burim krijimi të depozitave në vitin 2009 në emër të tyre, konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk kishte mundësi të krijonte gjendjen *cash* në këto dy momente, nuk është i bazuar. Edhe ky korrektim i kryer nga Kolegji, nuk ka efekt përcaktues në zgjidhjen e çështjes. Po ashtu, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike pakësim të gjendjes së *cash*-it dhe identifikimin e tyre si burim krijimi pasurie në deklaratën periodike apo atë të pasurisë *vetting*, qasje që është pasqyruar edhe në analizën financiare²² të kryer prej tij pasi është njohur me rezultatet e hetimit, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjendjet e deklaruara *cash* nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të parë, për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

²² Në analizën financiare të paraqitur në rezultatet e hetimit, si dhe në ankim, subjekti ka pretenduar pakësim të gjendjes *cash* vetëm në vitin 2008 dhe vitin 2012. Përpos faktit që këto specifikime bien ndesh me pretendimet në ankim, nga deklaratat periodike vjetore rezulton se edhe për këto vite, subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti jashtë sistemit bankar (*cash*-i).

14.8. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, pasi kontrolloi analizën financiare të subjektit sipas pretendimeve në ankim, trupi gjykues vëren se ai gjendet në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi në momentin e pagesës, më datë 05.10.2010, për krijimin e pasurisë së deklaruar si burim për shlyerjen e këstit të parë, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 4.141.414 lekë në vitin 2006. Nëse analiza do të kryhej sipas kushteve kontraktore të përcaktuara nga palët dhe aktet e veprimet në periudhën e ndërmjetme, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me një balancë negative prej (-) 6.299.208 lekësh për pagesën e këstit të parë me vlerë 60.000 euro, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

*II. Të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë*

15. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të dy pasurive: një garazh me sipërfaqe 25 m² dhe një tokë me sipërfaqe 900 m², në {***}²³, të ardhurat nga shitja e pasurisë së cituar në këtë rubrikë, me sipërfaqe 210,3 m², ndodhur në rrugën “{***}” në vitin 2013, në vlerën prej 450.000 eurosh. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive në vitin 2014, por pasuria, shitja e së cilës pretendohet se ka shërbyer si burim, nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës për ligjshmërinë e pasurive, bazuar në të ardhurat e deklaruara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Për këtë arsye, në analizën financiare të të ardhurave të përfituara, Komisioni nuk përfshiu në analizën e burimeve të ligjshme një vlerë prej 137.788 eurosh, që përbënin kapitalet e përfituara nga personi i lidhur.

15.1. Subjekti kundërshton përfundimin e Komisionit si më sipër, duke kërkuar të përlllogaritet e plotë vlera prej 450.000 eurosh, e përfituar nga shitja e apartamentit. Subjekti potencon se detyrimi i derdhjes së tatimeve i përkiste shoqërisë ku personi i lidhur ka qenë ortak [“{***}” ShPK]. Sipas tij, detyrimet tatimore për këtë shumë janë njohur, paguar e deklaruar nga personi juridik në fjalë.

15.2. Nga analiza e akteve në fashikull, përkundër pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Nga analiza e dokumentacionit në dosje, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurive garazh me sipërfaqe 25 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë dhe pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 900 m², të ndodhur në {***}, Tiranë. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të vlerës 137.788 euro, e përfituar nga transaksioni i kryer nëpërmjet veprimeve: (i) të ndarjes së pasurisë së shoqërisë; (ii) kredisë bankare; dhe (iii) përfitimit nga personi i lidhur, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, që passjell gjendjen e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të tjera e mbulimin e shpenzimeve në vitin 2013. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit bazohet mbi analizën e shtjelluar në vijim.

²³ Blerë respektivisht në qershor dhe janar 2014, në një vlerë totale prej 5.325.000 lekësh.

15.3. Personi i lidhur ka investuar 49.000 lekë në kapitalin themeltar prej 100.000 lekësh të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, regjistruar në vitin 2004. Në vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen dhe shitjen e apartamentit objekt analize, me sipërfaqe 210,3 m². Apartamenti u porositi në emër të shoqërisë në datën 11.04.2008, për vlerën 599.360 euro. Sipas kontratës së porosisë, palët kishin shlyer pagesën 500.000 euro në kohën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa vlera e mbetur, 99.360 euro, do të shlyhej me dorëzimin e apartamentit. Sipas korrespondencës që ka pasur Komisioni me sipërmarrësin, apartamenti u është dorëzuar e vënë në përdorim porositësve në fund të vitit 2012²⁴.

15.4. Sipas deklaratës periodike vjetore për vitin 2013, në vijim të vendimit të datës 10.01.2013 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë, apartamenti ka kaluar në favor të personit të lidhur/bashkëshortes, “për ndarjen në përdorim personal dhe në pronësi” të zyrave të shoqërisë, të blera me kredinë e marrë nga Tirana Bank më 16.05.2008, në emër të shoqërisë. Si rezultat i kësaj ndarjeje, personi i lidhur përfitonte një apartament prej 210,3 m² në përdorim e pronësi. Ortaku tjetër përfitoi apartamentin me sipërfaqe prej 193,7 m².

15.5. Po ashtu, referuar vendimit të asamblesë së shoqërisë, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit dhe ortaku i saj [respektivisht pronarë të 49% dhe 51% të kapitalit²⁵] morën përsipër edhe shlyerjen e vlerës së kredisë së mbetur, në masën 50% secili. Kredia e dakordësuar për blerjen e një apartamenti me vendndodhje në rrugën “{***}”, Tiranë, prej 404 m², në datën 16.05.2008 ka pasur për objekt një vlerë prej 450.000 eurosh dhe është reduktuar në datën 06.10.2008, në 420.000 euro. Nga kjo kredi, 170.000 euro janë disbursuar më 22.05.2008 dhe 250.000 euro të tjera më 07.10.2008²⁶. Nga deklarata periodike vjetore për vitin 2013, rezulton po ashtu se pjesa takuese e kredisë së pashlyer, deklaruar sipas gjendjes më 31 dhjetor të vitit 2013, ishte 175.250 euro.

15.6. Nga ana tjetër, nga përgjigjja zyrtare dërguar Komisionit nga Drejtoria Tatimore Vlorë²⁷, ngjarjet/veprimet me natyrë financiare të viteve 2008-2014, nuk janë pasqyruar në aktet financiare të dorëzuara nga shoqëria, përkundrazi. Këto ngjarje/veprime që kanë shoqëruar vendimin e sipërcituar të asamblesë së ortakëve, nga edhe derivon pasuria objekt analize, nuk janë pasqyruar në dokumentacionin e depozituar në këtë institucion. Në kushtet që shoqëria “{***}” ShPK nuk i ka pasqyruar ngjarjet financiare të ndodhura pas vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 10.1.2013²⁸, për to nuk është paguar tatim. Nga përgjigjja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, rezultoi po ashtu se shoqëria “{***}” ShPK ka deklaruar fitim për vitet 2005-2013, por nuk ka shpërndarë dividend.

²⁴ Sipas përgjigjes me shkrim dërguar Komisionit më datë 27.01.2020 nga shoqëria “{***}” ShPK.

²⁵ Sipas vendimit të Komisionit (në faqen 25), referuar faqes zyrtare të QKB-së, bashkëshortja e subjektit ka qenë ortakë themeluese me 49% të kapitalit. Shoqëria, krijuar me vendim gjykate, datë 03.03.2004 dhe objekt veprimtarie “në fushën e ndërtimit dhe të tregtimit të materialeve të ndërtimit, importin dhe eksportin e tyre”.

²⁶ Shih faqet 25 e 26 të vendimit të Komisionit, sipas shkresës së Tirana Bank, datë 31.05.2019.

²⁷ Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, shkresë nr. {***} prot., datë 24.04.2019.

²⁸ Shkresa referuar më sipër, në poshtëshënimin nr. 27.

15.7. Me fjalë të tjera, “ndarja për përdorim personal dhe në pronësi” e apartamenteve të blera për zyra secilit ortak, si dhe ndarja e detyrimeve të mbetura të kredisë nuk janë pasqyruar në bilancet e shoqërisë “{***}” ShPK. Edhe vetë kjo shoqëri ka konfirmuar gjatë hetimit administrativ, në dhjetor 2019, se këto ambiente nuk janë regjistruar apo evidentuar si pasuri të shoqërisë as në QKB, as në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë, pasi duke qenë në kushtet e “kontratës së porosisë”, nuk mund të regjistrohej në regjistrat e shoqërisë.

15.8. Pesë (5) muaj pas vendimit në fjalë të asamblesë së ortakëve, që “apartamentet e blera nga shoqëria” i ndau për përdorim personal në datën 18.06.2013, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK apartamentet²⁹ me sipërfaqe totale 193,3 m², kundrejt çmimit 313.038 euro, i likuiduar me kredinë bankare të marrë dhe të shlyer me të ardhurat e shoqërisë “{***}” ShPK. Nga ky çmim, personi i lidhur ka marrë përsipër të paguante pjesën takuese të kredisë së mbetur, e konkretisht 175.200 euro. Nga këto akte, rezulton që shoqëria tregtare ku personi i lidhur ishte pronar me 49%, në dhjetor 2012 kishte marrë në dorëzim apartamentin, në janar 2013 ndau pasuritë për përdorim personal mes dy ortakëve. Në periudhën e ndërmjetme, këto pasuri nuk gjetën asnjë pasqyrim në aktet financiare si kapital i shoqërisë, ndonëse asambleja e ortakëve disponoi për ndarjen e tyre vetë ortakëve, në përdorim personal.

15.9. Nga aktet në fashikull, rezulton se shoqëria tregtare nuk ka shpërndarë dividend për asnjë vit të harkut kohor që nga krijimi [2005-2013], ndërsa ka pasur vite me fitime të konsiderueshme, sikurse edhe vite me fitim të papërfillshëm. Në vendimin e asamblesë së ortakëve, në janar 2013, këta të fundit nuk rezultojnë të kenë marrë vendim, qoftë edhe me efekt prapaveprues, për t’u shprehur në ndonjë formë për mënyrën se si do të përlllogariteshin fitimet, detyrimet ndaj të tretëve apo përfitimet e secilit prej tyre. E thënë ndryshe, në një moment kyç në veprimtarinë e shoqërisë, në prag të shkëputjes së një ortaku me 49% të kapitalit të shoqërisë, asambleja nuk rezultoi të ketë pasur në fokus apo të ketë dokumentuar në vendim nga këto veprime financiare bazike e logjikisht të pritshme, përfshirë edhe vlerën sasiore të përdorur si bazë përlllogaritjeje të pjesës takuese, vlerën e detyrimeve ndaj të tretëve (përfshirë ato ndaj buxhetit të shtetit) apo mënyrën se si do të përlllogariteshin e përktheheshin dividendët e shpërndarë ndër vite, nëse ishin ata në thelb të përfitimit të apartamentit nga personi i lidhur. Përkundrazi, personi i lidhur dhe ortaku kanë disponuar për ndarjen e pasurisë pa referuar në pasqyra financiare apo detyrime të evidentuara, nëse kishte. E vetmja referencë është ajo të vlera e mbetur e kredisë. Sjellim në vëmendje që personi i lidhur ka qenë gjatë gjithë këtij harku kohor një nga dy ortakët e kësaj shoqërie e, për rrjedhojë, në rol vendimmarrës, të cilin e ndante vetëm me një (1) individ tjetër në asamblesë të ortakëve.

15.10. Një muaj pas blerjes së apartamentit, në datën 23.07.2013, personi i lidhur/bashkëshortja e ka shitur atë kundrejt vlerës 450.000 euro³⁰. Subjekti argumentoi se kjo

²⁹ *Bleu ambientin me sipërfaqe 8,8 m² dhe apartamentin me sipërfaqe 184,5 m².*

³⁰ *Sipas kontratës noteriale me nr. {***} rep., nr.{***} kol. Blerësi ka kryer pagesën në llogarinë bankare të personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në Raiffeisen Bank.*

pasuri e porositur nga shoqëria tregtare, ishte shlyer në masën 137.788 euro nga kredia e shoqërisë³¹. Rezulton se personi i lidhur ka marrë një kredi personale në vlerën 175.250 euro, disbursuar më 31.03.2014, me qëllim shlyerjen e detyrimit të marrë përsipër për llogari të kredisë së marrë nga shoqëria “{***}” ShPK. Nga ana tjetër, kjo kredi rezulton të jetë shlyer me të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit. Me fjalë të tjera, kredia e marrë nuk ka shërbyer për të shlyer kredinë e shoqërisë, pasi ndërkohë personi i lidhur kishte shitur apartamentin.

15.11. Në vijim dhe sikurse analizohet më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e shumës prej 137.788 eurosh, nën dritën e kriterëve të përcaktuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se detyrimet tatimore, edhe për këtë kapital të përfutur nga personi i lidhur, janë përgjegjësi e shoqërisë tregtare [“{***}” ShPK], u gjet jobindës. Ky konkluzion mbështetet në disa aspekte. Së pari, sikurse ka argumentuar edhe Komisioni, personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja, në cilësinë e ortakës, ka qenë përfshirë në vendimmarrje për të gjitha veprimet juridike të kryera në funksion të aktivitetit të shoqërisë, përfshirë edhe hapat që janë ndjekur për krijimin e kësaj pasurie dhe disponimin e saj. Nën dritën e këtij funksioni vendimmarrës dhe kësaj cilësie, të mbajtur prej saj deri në qershor 2013, nuk mund të argumentohet se personi i lidhur nuk kishte dijeni apo është çliruar nga çdo përgjegjësi për pasojat apo detyrimet që shoqërojnë një vendimmarrje të shoqërisë tregtare, në kushtet kur ajo ishte një ndër dy ortakët që disponuan për mënyrën e administrimit, investimet dhe mosshpërndarjen e dividendëve apo detyrimet e tjera fiskale të shoqërisë, si pasojë e të cilave do të përllogaritej edhe pjesa e saj takuese në momentin e ndarjes së pasurive. Në kushtet kur shoqëria nuk ka shpërndarë asnjëherë dividend, si një ndër dy ortakët e shoqërisë, personi i lidhur ishte në dijeni jo vetëm të situatës financiare të shoqërisë, por edhe të vlerave financiare të fitimit të pritshëm apo të mundshëm për t’u disponuar nga ortakët, pasi të likuidoheshin detyrimet financiare ndaj shtetit, apo të një plani veprimi në funksion të shlyerjes së këtyre detyrimeve, sipas rregullimeve ligjore të nenit 33, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për tatimet mbi të ardhurat që janë në ngarkim të asamblesë së ortakëve në shoqërinë tregtare, si kusht për shpërndarjen e dividendit.

15.12. Argumentet e subjektit që tentojnë t’i japin vlerë prevalue aktit të sjellë prej tij pasi i kaloi barra e provës, e konkretisht, “aktmarrëveshjes³²” që daton dy ditë pasi personi i lidhur kishte blerë apartamentin nga shoqëria, sipas së cilës shoqëria “njihte, pranonte e merrte përsipër” të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga vendimi i asamblesë së ortakëve të datës 10.01.2013, paraqitet pa vlerë provuese për këto pretendime, për disa arsye. Së pari, edhe nëse

³¹ Referuar përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2, shuma prej 313.038 eurosh, që është vlera e pasurive të përfutuara nga bashkëshortja e subjektit, i është likuiduar shoqërisë “{***}” ShPK, me kredinë bankare të marrë dhe të shlyer me të ardhurat e shoqërisë “{***}” ShPK, deri në 31.12.2012.

³² Subjekti i referohet aktmarrëveshjes së ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 20.06.2013, sipas së cilës të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga zbatimi i vendimit të asamblesë së ortakëve, datë 10.01.2013, do të njihen, pranohen dhe paguhen nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK, pranë institucioneve tatimore, në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse.

abstragohet nga koha kur ky dokument u paraqit në hetim, që përkon me momentin kur subjekti u njoh me analizën financiare me balancë *negative* për atë vit nga Komisioni³³, personi i lidhur, në cilësinë e një ndër dy vendimmarrësve në shoqëri, ishte doemos në dijeni të situatës financiare të shoqërisë, gjendjes së detyrimeve të shlyera e pashlyera qoftë në momentin kur u mor vendimi i asamblesë së ortakëve për ndarjen e pasurisë për përdorim individual, qoftë në momentin kur ka blerë apartamentin nga shoqëria, më 18.06.2013. Ky moment kohor, blerja e pasurisë prej saj, ka ndodhur përpara “aktmarrëveshjes”, ndërsa kjo e fundit, sikurse një sërë veprimesh financiare të ndodhura pas vendimit të janarit 2013 nga asambleja e ortakëve, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar e referuar në asnjë akt të depozituar në institucione.

15.13. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ka edhe aspekte të tjera që e bëjnë të paprovuar ligjshmërinë e të ardhurave të fituara nga ky transaksion, për efekt të procesit. Sipas Standardeve të Kontabilitetit³⁴, aktive administrative të shoqërisë tregtare janë aktivet (me përjashtim të emrit të mirë), të cilat japin kontribut në flukset monetare të ardhshme si të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, që është në shqyrtim, ashtu edhe të njësisë të tjera që gjenerojnë mjete monetare. Sipas nenit 81 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, asambleja e shoqërisë miraton pasqyrat financiare vjetore e, për rrjedhojë, edhe këto ndryshime të kapitalit. Nën dritën e sa më sipër, porositja e ambienteve për zyrat nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes më datë 11.04.2008, do të duhet të ishte pjesë e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2012 ose 2013, për shoqërinë “{***}” ShPK. Blerja e këtyre aseteve nga shoqëria krijon efekte në pasqyrat financiare, për të cilat lindin detyrimet tatimore. Për rrjedhojë, pretendimi se ambientet nuk u pasqyruan në aktivet e shoqërisë pasi ato ishin thjesht një kontratë porosie, është i pabazuar dhe mbështet konkluzionin që përfitimet e vjela nga ndarja e pasurisë për përdorim personal nga personi i lidhur, nuk kapërcejnë pragun e ligjshmërisë, përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016. Nga aktet e sipërcituara [paragrafi 15.5], rezulton se në një kohë të shkurtër pas marrjes së ambienteve në përdorim në dhjetor 2012, në janar 2013, ortakët ndanë ambientin për përdorim personal, që nënkupton ndër të tjera se gjendja faktike e të drejtave mbi pasurinë nuk kishte asnjë pengesë të pasqyrohej në dokumentacionin financiar e kapitalin e shoqërisë, për sa kohë ortakët e dispononin me ndarje në pronësi individuale. Së dyti, në kushtet që shoqëria fitimin ndër vite nuk e kishte destinuar për dividend, dhe në këtë vendim nuk ka asnjë referencë për detyrimet tatimore, fakt që prezumohet i njohur nga ortakët, ndarja e pasurive, në thelb përbën një materializim të dividendit.

15.14. Në këtë drejtim, edhe pretendimi i subjektit se ortakët kanë rënë dakord që detyrimet tatimore t’i ngarkoheshin shoqërisë, apo që kjo dakordësi ka ndodhur sipas aktit të paraqitur si provë e re pas rezultateve të hetimit administrativ, vetëm *pasi* është blerë apartamenti nga personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja, përveçse bie ndesh me kronologjinë dhe përmbajtjen e veprimeve të kryera për disponimin e pasurive [marrjen në dorëzim dhe vendimin e asamblesë së ortakëve të janarit 2013], apo përgjegjësitë e personit të lidhur në

³³ Depozituar nga subjekti si “provë e re”, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ.

³⁴ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/ias_36_zhvleresimi_i_aktiveve.pdf

kapacitetin e ortakes në shoqërinë tregtare, në një këndvështrim alternativ, paraqiten si një përpjekje për të legjitimuar *post facto* aspekte të vendimmarrjes së ortakëve që gjithsesi nuk kanë prodhuar efekte për të paktën shtatë (7) vite në vijim. Për pasojë, ky argument gjendet pa peshë përcaktuese në këtë analizë, sikurse edhe pagesa e detyrimeve tatimore nga ortaku i vetëm, kryer gjatë procesit të hetimit administrativ të subjektit³⁵.

15.15. Trupi gjykues konstaton se si kronologjia e paraqitjes së “aktmarrëveshjes”, ashtu edhe koha kur janë kryer pagesat e tatimeve, apo fakti që veprime financiare me rëndësi për aktivitetin financiar të personit juridik nuk janë reflektuar në dokumentet e depozituara në administratën tatimore, paraqiten si përpjekje të subjektit për të shmangur problematikat që rezultojnë në krijimin e saj, e për të përmirësuar pozitën e tij në procesin e rivlerësimit duke legjitimuar veprimet e kryera në drejtim të krijimit të pasurisë vite pasi ky fakt ka ndodhur. Në kushtet që shlyerja e detyrimeve tatimore nuk është provuar bindshëm në asnjë formë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vlera 137.788 euro nuk e kalon testin e të ardhurave të ligjshme, të përcaktuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikën 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

15.16. Në përmbledhje, trupi gjykues vëren se personi i lidhur/bashkëshortja, në cilësinë e një prej ortakëve, ka disponuar si kapital *neto* në favor të saj ekuivalentin e vlerës prej 137.788 eurosh, në kushtet që shoqëria në të cilën ajo ishte vendimmarrëse, nuk kishte shpërndarë dividend apo proceduar me vendimmarrje për mbajtjen e tatimit në burim, sipas ligjit. Pasuria e përfutur si kapital *neto* është e konsiderueshme: personi i lidhur e shiti për 450.000 euro një pasuri të blerë rreth 313.000 euro, për të cilën nuk kishte shpenzuar asnjë shumë monetare. Realisht, kontributi i vetëm i saj në këtë aktivitet fitimprurës, deri në korrik 2013, kur pasuria e paluajtshme u shit, ishte kapitali fillestar prej 49.000 lekësh. Për sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit për vlerën 137.788 euro, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, viti 2013 rezulton me një balancë negative në shumën 19.739.307 lekë, dhe me pamundësi për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Pasuritë apartament, zyrë dhe garazh, ndodhur në Tiranë

16. Ndër pasuritë e deklaruara në deklaratën e rivlerësimit, marrë në analizë nga Komisioni, janë edhe tri pasuri të paluajtshme, deklaruar në vitin 2005: apartament, dyqan dhe garazh³⁶, në

³⁵ Gjatë procesit të rivlerësimit, e konkretisht më 01.06.2020, ortaku i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK ka marrë vendim të asamblesë të zbatojë vendimin e shtatë viteve më parë, atë të datës 10.01.2013, dhe aktmarrëveshjes datë 20.06.2013, për të shlyer dividendin për fitimet ushtrimore të periudhës 2006-2013. Sipas urdhërpagesës, për periudhën tatimore 2007, deklaruar me emërtim “Tatim mbi të ardhura nga dividendë dhe aksione detyrim principal, detyrim për 2007 – korrik 2020”.

³⁶ Përkatësisht me sipërfaqe 147 m² dhe 40 m². Nuk specifikohet sipërfaqja e garazhit. Vlera e njësisë/zyrës është deklaruar 54.150 USD, garazhi 10.000 USD. Nuk është deklaruar vlerë për apartamentin.

total në vlerën 134.150 USD, me vendndodhje në {***}³⁷. Në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e këtyre pasurive, ndër të tjera, një hua në shumën 60.000 USD nga një i afërm i tij³⁸. Në deklaratën periodike për vitin 2005, ky specifikim mungon, ndonëse subjekti ka deklaruar porositjen e tri pasurive dhe vlerën prej 134.150 USD. Komisioni ka konkluduar se subjekti e ka deklaruar për herë të parë huanë si burim krijimi të kësaj pasurie në procesverbalin e mbajtur në datën 24.7.2015, në ILDKPKI. Po ashtu, Komisioni ka konstatuar se nuk provohet me dokumentacion të kohës ekzistenca e huasë në vitin 2005, apo marrëdhënia midis palëve përgjatë viteve 2005 – 2014³⁹, në kushtet që për të dokumentuar ligjshmërinë e burimeve financiare të huadhënësit, subjekti ka depozituar vetëm dokumentacion me të dhënat bankare të huadhënësit. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë shumën e pretenduar të marrë hua si burim krijimi të pasurive të paluajtshme objekt i kësaj analize.

16.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkon që huaja në vlerën 60.000 USD të njihet si burim i ligjshëm për krijimin e këtyre pasurive. Subjekti potencon që e ka deklaruar këtë hua në ILDKPKI dhe në deklaratën *vetting* dhe, për rrjedhojë, duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2005. Mosdeklarimi i huasë në deklaratën periodike të vitit 2005, sipas tij, ka qenë pasojë e faktit se dispononte mjete financiare të mjaftueshme pasi kishte fituar lotarinë në ShBA.

16.2. Pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin që vlerësimi i Komisionit është i drejtë. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për huanë rezultojnë jobindëse e të paprovuara. Përpos këtij fakti, subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë edhe burime të ligjshme të mjaftueshme nga huadhënësi për të mbuluar vlerën e pretenduar të dhënë hua. Fakti që për herë të parë është pretenduar një marrëdhënie huadhënieje 10 vjet pasi kishte ndodhur, dhe vetëm gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2015, për pasuritë e krijuara nga subjekti, përforcon bindjen që këto rrethana faktike janë parashtruar për të përmirësuar situatën financiare pasi subjekti është ndërgjegjësuar për mungesën e burimeve. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit për këtë konkluzion shtjellohet në vijim.

16.3. Nga aktet në fashikull, rezulton se në deklaratën e rivlerësimit [*vetting*], në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar të ardhura nga lotaria “Gërvisht dhe fito” në ShBA, në vlerën *neto* prej 335.000 USD, të ardhura nga interesat bankarë për 12 vjet, 2005-2016, në vlerën 17.800 USD (afërsisht) dhe hua në vlerën 60.000 USD prej një të afërmi, përdorur për blerjen e apartamentit dhe garazhit. Subjekti ka deklaruar se huaja është shlyer në dy këste, nga 30.000 USD secili, në dhjetor 2015 dhe janar 2016. Në deklaratat periodike për periudhën 2005-2014, subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar as huanë, as detyrimin

³⁷ Nëpërmjet kontratës noteriale të sipërmarrjes, datë 19.8.2005, subjekti i rivlerësimit ka porositur te shoqëria “{***}” ShPK, zyrë me vlerë 54.150 USD dhe garazh me vlerë 10.000 USD.

³⁸ Huaja e marrë nga z. N. P. më 12.07.2005, sipas të njëjtit deklaram.

³⁹ Dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 2.10.2019, nga ILDKPKI-ja.

e mbetur ndaj huadhënësit, z. N. P.. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar në detaj përfitimin nga lotaria në ShBA, në deklaratën periodike për vitin 2005.

16.4. Nga dokumentacioni në fashikull⁴⁰, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë hua gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja, në vitin 2015. Konkretisht, në *procesverbalin* e mbajtur me atë rast, më datë 24.7.2015, në përgjigje të pyetjeve lidhur me të ardhurat e fituara nga lotaria në ShBA në vitin 2005, si dhe huanë në shumën 60.000 USD, marrë nga z. P., cilësuar si i afërm i bashkëshortes. Po aty, subjekti është shprehur se nuk ka shlyer asnjë këst të huasë, e cila është dakordësuar me deklaratë mes palëve. Për të provuar mundësinë financiare të huadhënësit, subjekti ka shpjeguar se ai ka aktivitet tregtar qysh prej vitit 1990, por edhe që “ka pasur edhe dërgesa transfertash në shuma të ndryshme nga vëllai i tij emigrant në Britaninë e Madhe”. Bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, subjekti ka dorëzuar dy akte të thjeshta⁴¹, që mbajnë përkatësisht datat 12.07.2005 dhe 30.01.2016, nëpërmjet të cilave kërkon të provojë marrjen dhe shlyerjen e huasë. Subjekti ka dorëzuar edhe një ekstrakt bankar nga Intesa SanPaolo Bank, për llogaritë e z. N. P., në monedhën GBP, për periudhën 1.1.2003 – 6.7.2009.

16.5. Së pari, në kushtet kur kjo hua nuk ka gjetur pasqyrim në asnjë dokument të kohës, nën dritën e detyrimeve që kishte subjekti i rivlerësimit sipas ligjit nr. 9049/2003 për deklarimin e detyrimeve në kohën e krijimit⁴², si dhe rëndësisë që kanë këto deklarata si provë në procesin e rivlerësimit, siç përcakton neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se prurja e akteve në fazën e kontrollit të kryer nga institucioni përgjegjës në vitin 2015, dështon të provojë ekzistencën e kësaj huaje me akte të kohës. Së dyti, pavarësisht dhe duke abstraguuar nga ky konstatim, subjekti nuk arriti të provojë as mundësinë e personit tjetër të lidhur për të dhënë huanë me burime të ligjshme, nën dritën e kriterëve të përcaktuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016⁴³. Nga dokumentacioni në fashikull, rezulton se ndonëse personi tjetër i lidhur ka pasur llogari rrjedhëse në monedhën GBP, USD dhe Euro [në Bankën Amerikane/Intesa SanPaolo], të cilat tashmë janë mbyllur, rezultojnë hyrje në shuma të konsiderueshme për dy prej monedhave, por pa asnjë detaj për dërguesin apo përshkrim tjetër specifikues. Po ashtu, gjithë shuma e hyrë në llogarinë në GBP, është tërhequr *cash* gjatë viteve 2001-2002, shuma në euro është tërhequr thuajse e gjitha në vitin 2005⁴⁴.

⁴⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 2.10.2019, dërguar Komisionit nga ILDKPKI-ja.

⁴¹ Përkatësisht, një deklaratë të thjeshtë të hartuar nga personi i lidhur/bashkëshortja, nënshkruar përveç saj edhe nga huadhënësi [sikurse edhe subjekti] për të mbështetur ekzistencën e huasë, si dhe një deklaratë të thjeshtë të huadhënësit [z. N. P.], që referon shlyerjen e detyrimit të huasë me dy këste.

⁴² Germa “dh” e nenit 4 të këtij ligji parashikon “detyrimin e deklarimit të [...] detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

⁴³ “[4.] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

⁴⁴ Konkretisht, nga llogaria në monedhën GBP, e cila është për periudhën 2001-2002, rezulton se janë kryer transferta hyrëse në vlerën totale 128.132,83 GBP, pa dërgues dhe pa përshkrim. Të gjitha shumat e hyra në llogari janë tërhequr cash, po gjatë viteve 2001-2002. Në këtë llogari evidentohen disa transferta hyrëse përgjatë periudhës 2003-2005, por pa specifikuar dërguesin dhe pa përshkrim. Përgjatë periudhës 2003-2004, janë kryer

16.6. Nga ana tjetër, nga hetimi administrativ⁴⁵ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se shuma e të ardhurave bruto të përfituara nga personi tjetër i lidhur për periudhën gusht 2002 deri në qershor 2003, ka qenë në vlerën 105.224 lekë, ndërsa për pesë muaj në vitin 2002 dhe për harkun kohor korrik 2003 - dhjetor 2005, nuk administrohen listëpagesa. Më tej, nga hetimi⁴⁶, po ashtu ka rezultuar se tri shoqëritë ku ky individ ka qenë në rolin e administratorit apo ortakut, në harkun kohor që fillon nga viti 2002, kanë rezultuar me humbje, nuk kanë deklaruar qarkullim e fitim dhe vetëm njëra prej tyre ka deklaruar fitim në vitin 2005. Nga ana tjetër, të ardhurat e përfituara në formë page rezultojnë vetëm nga njëri prej tri aktiviteteve, dhe duke filluar nga viti 2012.

16.7. Nga këto akte, trupi gjykues i Kolegjit vëren se mundësia e krijimit të të ardhurave me burim të ligjshëm për personin tjetër të lidhur nga aktiviteti privat në të cilin ai është përfshirë, nuk provohet. Po ashtu, në kushtet kur nga transfertat bankare hyrëse nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave, arsyeja e dërgimit apo lidhja/kontributi i personit tjetër të lidhur kundrejt krijimit të këtyre shumave, mbeten të papërbushura kriteret e përcaktuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre. Aktet e sjella nga subjekti në prapësim të rezultateve të hetimit⁴⁷, rezultojnë pa vlerë provuese për disa arsye. Së pari, dy deklaratat noteriale janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit e për pasojë, duke mos qenë dokumente të kohës, kanë vlerë të kufizuar provuese. Së dyti, nëpërmjet këtyre akteve, tentohet që cilësia e personit tjetër të lidhur të përfshijë edhe një individ tjetër, z. I. K., të padeklaruar më parë nga subjekti, qoftë ndër vite, qoftë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Së

transferta hyrëse me vlerë totale 48.011,31 GBP. Në vitin 2005, vit që subjekti ka marrë huanë, evidentohet vetëm një pagesë hyrëse, në datë 10.11.2005, me vlerë 29.906,22 GBP e më pas më datë 14.11.2005, z. N. P. ka transferuar vlerën 29.702,97 tek znj. D. P.. Nga llogaria në monedhën Euro, e cila është për periudhën 2005-2010, rezulton se përgjatë vitit 2005, janë kryer transfertat hyrëse në vlerën totale 50.752,6 euro, pa specifikuar dërguesin dhe pa përshkrim. Llogari mbajtësi, z. N. P., ka tërhequr cash gjatë vitit 2005 vlerën 50.272,6, në shuma të ndryshme, në janar, shkurt, qershor dhe dhjetor 2005. Shumat variojnë nga 900 euro në 21.550 euro.

⁴⁵ Referuar shkresës së dërguar Komisionit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për z. N. P..

⁴⁶ Siç rezulton nga përgjigjet zyrtare të dërguara Komisionit nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Durrës. Nga shkresa e DRT Tiranë, ka rezultuar se shoqëria ku ky individ ka qenë në cilësinë e administratorit në vitin 2002, ka rezultuar me humbje, ndërsa në harkun kohor 2003-2006 nuk ka deklaruar qarkullim e as fitim. Po bazuar kësaj shkrese, z. N. P. është administrator/ortak i një shoqërie tjetër, regjistruar më datë 6.06.2005. Pagat e përfituara nga z. N. P. prej shoqërisë fillojnë vetëm nga janari 2012. Referuar shkresës së dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, për një shoqëri tjetër, ku z. P. rezulton të ketë qenë administrator, fitimi për vitin 2005 është në vlerën 2.072.958 lekë.

⁴⁷ Subjekti ka sjellë tri akte, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, e konkretisht: dy deklaratat noteriale të lëshuara përkatësisht nga huadhënësi, z. P., dhe nga një individ tjetër, deklaruar si familjar i tij, z. I. K., hartuar në datat 08.07.2020 dhe 06.06.2020. Në deklaratën e parë, huadhënësi N. P., “rikonfirmon” dhënien e huasë, burimin e të ardhurave – paratë që i dërgoheshin atij në vite nga familjari i tij, z. I. K., rezident në Britaninë e Madhe – si dhe shlyerjen e saj përgjatë vitit 2015-2016. Deklaruesi tjetër, z. I. K., shprehet për marrëdhënien me huadhënësin N. P. si dhe dakordësinë e tij për dhënien e kësaj huaje nëpërmjet të ardhurave të dërguara prej tij në llogarinë bankare të huadhënësit, “një shumë rreth 40.000 GBP për t’ia dhënë hua D. G., për blerjen e një apartamenti”. Akti i tretë i sjellë është një statement bankar i z. K. nga një bankë në Britaninë e Madhe, për periudhën 2003-2004 dhe “Card Cash Statement” nga një institucion tjetër financiar për periudhën tetor 2003 – janar 2004.

tretë, edhe duke abstraguar nga risia e sjellë në një fazë të avancuar të procesit nëpërmjet prezantimit të një huadhënësi të ri, subjekti sërish nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e burimeve, në kushtet kur asnjë nga aktet nuk provon asnjë të dhënë në drejtim të këtij aspekti. Fakti që z. K. ka të ardhura në bankë, nuk shoqërohet qoftë me të dhëna për burimin e origjinës së tyre, sikurse as me lidhjen mes këtyre të ardhurave dhe transfertave hyrëse në llogaritë bankare të z. P.. Siç është theksuar më sipër, shumat e dërguara nuk kanë të dhëna për dërguesin, arsyen apo përshkrimin e çfarë ato përbëjnë. Së fundmi, llogaritë bankare për z. I. K., të dhënat e të cilave janë sjellë nga subjekti në cilësinë e provës, i përkasin një periudhe të mëhershme nga viti 2005, kohë kur deklarohet të jetë përfituara huaja nga z. P..

16.8. Në këto kushte, rezultoi e panevojshme kryerja e një analize për ligjshmërinë e burimeve që pretendohen të jenë përdorur. Nga i gjithë dokumentacioni i administruar në dosje, në lidhje me z. N. P., Kolegji vlerësoi se gjendja e disponueshme në llogaritë bankare nuk justifikohet me dokumentacion ligjor për të provuar burimin e tyre. Në përfundim, Kolegji konkludoi që huaja e pretenduar të mos përfshihej në të ardhurat e disponuara nga subjekti dhe personi i lidhur kundrejt krijimit të pasurisë objekt analize, pasi nuk u provuan as ekzistenca dhe as burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive e mbulimin e shpenzimeve të vitit 2005⁴⁸, parashikuar në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

IV. Apartamenti në Golem, Durrës, blerë në vitin 2005⁴⁹

17. Kjo pasuri, së bashku me një automjet, është pjesë e kontrollit të kryer nga Komisioni për vitin 2005. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka konkluduar se në vitin 2005, subjekti ka paguar të gjithë vlerën 26.000 euro, pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes në favor të shoqërisë ndërtuese. Po ashtu, Komisioni ka vendosur të përlllogarisë në vitin 2005, shpenzimet për blerjen e një automjeti, përfshirë edhe shlyerjen e detyrimeve doganore. Në vijim të analizës financiare të kryer, Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e pamundësisë për të kryer shpenzimet për krijimin e pasurisë për një balancë negative prej (-) 9.747.900 lekësh në vitin 2005.

17.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se pagesat e shumës kanë ndodhur në një kalendar të ndryshëm nga ai i përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes e ai ka paguar në vitin 2005, vetëm 17.500 euro. Në vitin 2006, pasi ka shkëmbyer me kunatin apartamentin e porositur, ka dakordësuar për një apartament tjetër me sipërfaqe më të madhe [72 m²] në të njëjtën ndërtesë. Meqenëse çmimi i shitjes së apartamentit në vitin 2006 ishte më i lartë se në vitin 2005, diferencën që rezultonte nga rritja e çmimit do

⁴⁸ Analiza financiare e vitit 2005 e detajuar gjendet në shkakun e VI të këtij arsyetimi, pas analizës për pasurinë automjet “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2004 dhe targuar në vitin 2005.

⁴⁹ Me sipërfaqe 58,2 m², porositur nga subjekti me kontratën e sipërmarrjes së datës 28.4.2005 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me palë shoqërinë “{***}” ShPK.

ta paguante kunati i tij, ndërkohë subjekti do të paguante vetëm vlerën 9.000 euro, për sipërfaqen shtesë 13,8 m², të përfituar prej tij në apartamentin e ri.

17.2. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit që *edhe* për këtë pasuri tentojnë të paraqesin një kalendar pagesash të ndryshëm nga ai i përcaktuar në kontratë, në funksion të përmirësimit të situatës financiare me balancë negative, janë të pabazuara dhe jobindëse. Po ashtu, është i drejtë vlerësimi i Komisionit se vlera e përfituar shtesë nga shkëmbimi, nuk përmbush kriteret e ligjshmërisë. Në kushtet kur subjekti ka gjeneruar një vlerë 6.000 euro fitim, për të cilën nuk rezultojnë të shlyera detyrimet tatimore, mospërfshirja në të ardhurat në dispozicion të tij në vitin 2006, është konkluzioni i drejtë. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

17.3. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie shkëmbimi në deklaratën periodike për vitin 2006. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar prenotimin e apartamentit në fjalë dhe ka referuar kontratën e sipërmarrjes, por jo detyrime të pashlyera ndaj ndërtuesit. Edhe në deklaratën periodike për vitin 2006, plotësuar më 21.03.2007, subjekti nuk ka deklaruar asnjë shtesë të ardhurash, përveç kursimeve nga paga, ndërsa në rubrikën për detyrimet financiare, ka referuar kredinë bankare në vlerën 1,5 milionë lekë nga Banka Raiffeisen, marrë në shkurt 2006 nga bashkëshortja, dhe vlerën e interesit të shlyer. Shitja e këtij apartamenti dhe blerja e tjetrit janë deklaruar në mars 2008, në deklaratën për vitin 2007 [datë 19.03.2008], sikurse edhe vlerat përkatëse – 32.000 euro e 41.000 euro. Në këtë rubrikë, subjekti ka deklaruar “pa likuiduar 16.000 euro”, që u referohen pagesave për apartamentin tjetër, analizuar në vijim.

17.4. Nga ana tjetër, në kontratën e sipërmarrjes, referuar në deklaratën periodike të vitit 2005, palët kanë specifikuar që pagesat do të kryheshin si vijon: 10.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës [28.04.2005] dhe brenda tre muajsh pjesën e mbetur. Me fjalë të tjera, në vitin 2005 subjekti duhet të kishte paguar 26.000 euro në harkun kohor mes prillit dhe korrikut 2005. Nga ana tjetër, subjekti ka paraqitur dy kalendarë pagesash të ndryshëm nga kontrata apo nga deklaratat periodike vjetore, përkatësisht me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe në prapësime të rezultateve të hetimit. Nëpërmjet mandatpagesave parashtrohet një kalendar pagesash që zgjat dy vite përkundër gjysmës së dytë të një viti [2005]. Këta kalendarë bien ndesh me deklaratat periodike vjetore të viteve përkatëse, si dhe me kontratën e sipërmarrjes. Sipas mandatpagesave, subjekti ka pretenduar pagesën e 7.500 eurove në vitin 2005 dhe 7.500 eurove të tjera në vitin 2006, e në prapësimet me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se ka paguar 17.500 euro në vitin 2005, kushtëzuar nga ecuria e punimeve.

17.5. Pa përsëritur rëndësinë që paraqesin deklaratat periodike të subjekteve në procesin e rivlerësimit si provë në këtë proces, trupi gjykues vëren se nga të dyja deklaratat e kohës [2005 e 2006], por edhe në vijim, mund të deduktohet vetëm që pagesat janë kryer sipas përcaktimeve kontraktore. Konkretisht, ndryshe nga sa pretendon subjekti, në procesin e hetimit administrativ për pagesë të *pjesshme* të vlerës së apartamentit deri në fund të vitit 2005,

deklarata periodike e atij viti nuk referon ndonjë detyrim kundrejt shoqërisë ndërtuese. Përkundrazi, në atë deklaratë [plotësuar më 27.03.2006], subjekti ka deklaruar krijim pasurie – apartamentin “56 m²”, në Golem dhe kontratën e sipërmarrjes – dhe *asnjë* detyrim në rubrikën përkatëse të detyrimeve financiare⁵⁰, apo në rubrikën ku deklarata referon të dhënat për identitetin e personave ndaj të cilëve ekzistojnë këto detyrime. Në të dhënat konfidenciale, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga lotaria në ShBA.

17.6. Këto akte të kohës, lexuar në harmoni me kontratën e sipërmarrjes dhe me deklaratën periodike për vitin 2006, tregojnë se çmimi i apartamentit është shlyer brenda vitit 2005, sipas kalendarit të përcaktuar në kontratë, e konkretisht: kësti i parë me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes, datë 28.04.2005, ndërsa pjesa që mbetet, 16.000 euro, sipas nenit 2 të kontratës, duhet të jetë shlyer brenda tre muajve nga lidhja e saj. Më tej, në nenin 5 të kontratës, palët kanë dakordësuar se dorëzimi i apartamentit do të bëhej jo më vonë se muaji *dhjetor* i vitit 2005. Nga sa më sipër, rezulton që përcaktimet kontraktore për mënyrën e pagesës paraqiten në të njëjtën linjë e kalendar me sa ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit. Së fundmi, edhe deklarata e hartuar nga subjekti e kunati i tij në momentin e shitjes së apartamentit⁵¹, referon kontratën e sipërmarrjes për sa i përket pagesës brenda tre muajve nga hartimi i saj.

17.7. Duke abstraguar nga analiza e mësipërme për kontradiktat mes kalendarit të mandatpagesave dhe akteve të kohës, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se mandatpagesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën e pasurisë *vetting*, kanë probleme edhe nga ana formale, parë nën dritën e dispozitave ligjore të kohës⁵². Të katërta mandatet nuk kanë numër serial dhe tri prej tyre as numër mandati⁵³. Në një rast, mungon edhe nënshkrimi i

⁵⁰ Faqe 5 e formularit të deklaratës, e cila udhëzon në mënyrë specifike deklarimin e detyrimeve të mbetura ende të pashlyera nga deklarimi i mëparshëm, për subjektin deklarues e personat e lidhur.

⁵¹ Deklarata noteriale, datë 24.08.2007, mes subjektit dhe z. Y./vëllai i personit të lidhur/bashkëshortes. Deklaruesit shprehen se: “[...] Këstet e tjera deri në likuidimin e plotë të vlerës së apartamentit do të likuidoheshin brenda 3 muajve, në marrëveshje mes palëve [...]”. Pasqyruar e cituar edhe në faqen 33 të vendimit të Komisionit.

⁵² Neni 9 i ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin” (në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve), parashikonte ndër të tjera, kriteret e formës dhe të vlefshmërisë së dokumenteve justifikuese, referuar “Sistemit kontabël të përgjithshëm”: “Dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe duhet të përmbajë: a) emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën; b) emërtimin e ndërmarrjes dhe të njësisë organizative brenda saj, që lëshon dokumentin, formën juridike dhe adresën e ndërmarrjes; c) tregimin e personit ose të njësisë administrative që urdhëron kryerjen e veprimit, të personit që ekzekuton veprimin, si dhe, në varësi të organizimit të lëvizjeve të vlerave e të veprimeve financiare, tregimin dhe firmën e personit që merr në ngarkim vlerat materiale apo monetare; ç) përshkrimin e përmbajtjes së objektit të veprimit apo të ngjarjes tjetër dhe, në varësi të natyrës së këtyre të fundit, treguesit sasiore dhe vlerorë; [...]dokumenti justifikues, duhet të përmbajë ndër të tjera, të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e vlerorë, personat që kanë autorizuar dhe ekzekutuar veprimin, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”. Shih edhe vendimin e Kolegjit në çështjen (JR) nr. 8/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. N..

⁵³ Mandatpagesat kanë të dhënat si vijojnë: (i) datë 8.6.2005 [pa nr. dhe pa nr. serial], në shumën 2.500 euro, me përshkrimin: “Arkëtuar nga z. Artur Gaxhi për blerje apartamenti sipas kontratës” [mbiemri është plotësuar Gaxhi dhe jo Gaxha], firmosur nga financieri, administratori i shoqërisë dhe subjekti, vulosur me vulën e

administratorit. Për më tepër, kryerja e veprimeve me arkë, sipas mandatarkëtimeve, nuk rezulton të ketë qenë parashikuar nga palët në kontratë. Së fundmi, duke abstraguuar sërish nga përcaktimet kontraktore e mungesa e deklarimeve të këtyre veprimeve nga subjekti në vitet 2005 dhe 2006, në alternativën që pagesat kanë ndodhur në këtë kalendar, që sipas subjektit “kanë ndjekur ecurinë e punimeve”, rezultoi se mandatpagesat nuk mund të marrin vlerë provuese, pasi nuk plotësojnë elementet e formës sipas përcaktimeve ligjore dhe nuk janë në përputhje me aktet e kohës së krijimit të marrëdhënies juridike.

17.8. Në analizë të pretendimeve të subjektit për pagesa të shtrira e të mëvonshme në kohë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto mandatpagesa, në ndryshim nga ato të shoqërisë “{***}” ShPK, bien ndesh me gjithë aktet e kohës, si dhe nuk plotësojnë elementet e formës, duke bërë kështu që konkluzioni i Komisionit për mospranimin e tyre, të jetë i bazuar në ligj e në prova. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, pagesa e plotë e apartamentit objekt analize u përlllogarit si edhe në Komision, e kryer brenda vitit 2005. Në kushtet që edhe vetë subjekti nuk ka deklaruar detyrim të pashlyer në deklaratën e vitit 2005, pretendimet e mëpasme për pagesë sipas mandatarkëtimeve, në momente të ndryshme të vitit 2006, dhe në vlerë të ndryshme nga kontrata në vitin 2005, janë pa peshë provuese.

17.9. Subjekti ka nënshkruar një akt nëpërmjet të cilit tjetërsoi të drejta reale pronësie mbi apartamentin e porositur në vitin 2005 te një familjar i tij⁵⁴. Pavarësisht nga emërtimi si *deklaratë noteriale*, nga përmbajtja, nëpërmjet këtij akti, palët kanë rënë dakord që të tjetërsonin të drejtat e pronësisë nga subjekti [dhe personi i lidhur] te vëllai i personit të lidhur/bashkëshortes së subjektit, kundrejt vlerës prej 32.000 eurosh. Ky deduktohet të ketë qenë edhe kuptimi i subjektit, pasqyruar në deklaratën periodike për vitin 2007, ku është shprehur për *shitje* të apartamentit. Për rrjedhojë, në kushtet që subjekti përfitoi 6.000 euro fitim nga shitja e një pasurie, kjo diferencë duhej t’i nënshtrohej shlyerjes së detyrimeve tatimore sipas parashikimeve të germave “dh” dhe “e” të nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, në fuqi në momentin e kryerjes së veprimeve, në mënyrë që të konsiderohej e ardhur e ligjshme, në kuptim të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka provuar pagesën e këtyre detyrimeve, as në kohën e formalizimit të kontratës së shitjes. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për mospërfshirjen e kësaj vlere në analizën financiare të vitit 2007, është i drejtë. Edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj, në kontroll të asaj të kryer nga Komisioni, kjo vlerë nuk u përfshi

shoqërisë; (ii) datë 13.10.2005 [pa nr. dhe pa nr. serial], në shumën 5.000 euro, me përshkrimin: “Blerje apartamenti në Golem nga Artur Gaxhi” [mbiemri është plotësuar Gaxhi dhe jo Gaxha], shënuar emri i administratorit të shoqërisë dhe firmosur me porosi në emër të tij, vulosur me vulën e shoqërisë, firmosur nga subjekti; (iii) datë 11.1.2006 [pa nr. dhe pa nr. serial], në shumën 2.500 euro, me përshkrimin: “Blerje apartamenti nga Artur Gaxha në Golem”, shënuar emri i administratorit, por nuk është firmosur apo vulosur me vulën e shoqërisë; dhe (iv) nr. 60, datë 14.6.2006 [pa nr. serial], në shumën 5.000 euro, me përshkrimin: “U pagua nga Artur Gaxha kundrejt kontratës”, firmosur nga financieri, administratori i shoqërisë, vulosur me vulën e shoqërisë dhe firmosur nga subjekti.

⁵⁴ Palët shprehen se: “[...] Këtë apartament z. Artur Gaxha e ka vënë në dispozicion të z. V. Y., pasi prej tij ka marrë shumën 32.000 euro [...]”.

në të ardhurat që kanë shërbyer për të përballuar shpenzimet e krijimit e pasurive për vitin përkatës.

17.10. Në përfundim, për periudhën e kryerjes së pagesës së kësteve për likuidimin e apartamentit, Kolegji iu referua kontratës së sipërmarrjes, e cila, si akt noterial, i hartuar me vullnet të lirë nga palët, ka fuqi të plotë provuese. Pas kontrollit të analizës së Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të krijonte këtë pasuri, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

V. Apartamenti në Golem, Durrës, porositur në vitin 2006⁵⁵

- 18.** Disa aspekte të shkaqeve të ankimit që lidhen me këtë pasuri janë shtjelluar më sipër, së bashku me pasurinë e analizuar në rubrikën e numërtuar “I”, që i përket apartamentit në rrugën “{***}” Tiranë, deklaruar e krijuar pjesërisht nga të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti. Subjekti ka deklaruar porositjen e këtij apartamenti në Golem në vitin 2006 dhe revokimin e kontratës në vitin 2010. Komisioni vlerësoi se vlera 35.000 euro është likuiduar nga subjekti gjatë vitit 2006, sipas kontratës së sipërmarrjes sipas kushteve kontraktore, e konkretisht: 25.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe 10.000 euro në datën 25.9.2006 – ndërsa një kredi prej 1.500.000 lekësh, marrë për mobilim⁵⁶, nuk ka shërbyer për prenotimin e apartamentit objekt shqyrtimi. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e pasurive të paluajtshme, pagesën e kryer për porositjen e apartamentit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera përgjatë vitit 2006.

18.1. Subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit duke pretenduar se pagesat janë kryer në një kalendar tjetër. Plani i pagesave është kryer duke ndjekur ecurinë e punimeve. Apartamenti është dorëzuar në fund të vitit 2010, ndonëse në kontratën e sipërmarrjes parashikohej të mbaronte në dhjetor 2006. Kësti i parë, 25.000 euro, është paguar në vitin 2007 dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë, 16.000 euro, është paguar në pjesë në dy vitet në vijim. Si provë në mbështetje të këtij kalendari, subjekti potencon deklarin në deklaratën periodike të vitit 2007, për detyrimin e mbetur prej 16.000 eurosh ndaj shoqërisë ndërtuese. Që pagimi i shumës 11.000 euro është kryer gjatë vitit 2008, sipas subjektit, provohet me: (i) mandatet e depozituara [dy mandate me vlerë 3.000 euro dhe një mandat me vlerë 5.000 euro]; (ii) deklarin e shumës 11.000 euro të paguar, si dhe pakësimin e detyrimit ndaj shoqërisë, mbetur si detyrim vlera 5.000 euro, në deklaratën periodike të vitit 2008; (iii) provat e sjella nga subjekti⁵⁷. Komisioni ka gabuar duke mos pranuar si burim të ligjshëm të pagesës së kështit

⁵⁵ Me sipërfaqe 72 m², porositur me kontratën noteriale të sipërmarrjes, datë 27.6.2006 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.].

⁵⁶ Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se më datë 24.1.2006, personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja dhe vetë subjekti kanë lidhur kontratë kredie (personale, mobilim etj.) me Raiffeisen Bank. Shih edhe referimin më sipër për këtë kredi në deklaratën periodike për vitin 2006, në shkaku IV të ankimit.

⁵⁷ Subjekti ka depozituar një situacion punimesh të vitit 2010, nga shoqëria “{***}” ShPK.

të parë vlerën 6.000 euro të përfituar “nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes” për apartamentin me sipërfaqe 58, 2 m². Gjithashtu, subjekti kërkon që të përfshihen në analizë për këtë pasuri: (i) kredia e mobilimit, me vlerë 1.500.000 lekë nga Raiffeisen Bank; (ii) humbja nga kurset e këmbimit, me vlerë 172.214 lekë; dhe (iii) shpenzimet për telefoni celulare, në vlerën 306.456 lekë.

18.2. Nga analiza e akteve në fashikull dhe e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit për këtë apartament, është i drejtë. Pas kontrollit të analizës së Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer për porositjen e apartamentit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera gjatë vitit 2006. Ky konkluzion bazohet në arsyetimin që vijon.

18.3. Sipas kontratës noteriale të sipërmarrjes⁵⁸, çmimi i apartamentit ishte 41.000 euro dhe pagesat do të kryheshin si vijon: 25.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, 10.000 euro deri në 25.09.2006 dhe 6.000 euro me marrjen në dorëzim. Sipas kontratës, dorëzimi do të kryhej brenda dhjetorit 2006. Kjo kontratë nuk ka gjetur asnjë pasqyrim në deklaratën periodike të vitit 2006. Për herë të parë, siç referohet më sipër në paragrafin 17.3, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën për vitin 2007 dhe së bashku me shitjen e apartamentit tjetër [analizuar në shkakun IV të ankimit më sipër]. Në këtë moment kohor, subjekti ka deklaruar edhe përfitimin e 32.000 eurove nga shitja e apartamentit tjetër dhe blerjen e këtij apartamenti në çmimin 41.000 euro, nga të cilat 16.000 euro të mbetura pa shlyer. Në deklaratat periodike të viteve në vijim, 2008 dhe 2009, subjekti ka deklaruar përkatësisht shlyerjen e detyrimit prej 11.000 eurosh dhe detyrimin e mbetur prej 5.000 eurosh shoqërisë.

18.4. Nga këto akte, rezulton që në harkun kohor prill 2005 – qershor 2006, subjekti ka porositur dy apartamente në Golem, në kompleksin turistik që ndërtonte e njëjta kompani, me vlera përkatësisht 26.000 dhe 41.000 euro, por ka deklaruar në kohë reale vetëm apartamentin e parë. Apartamenti i dytë është deklaruar vetëm si derivat i shitjes së të parit, në vitin 2007. Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka pretenduar se pagesën për apartamentin e parë kunati e ka shlyer gjatë një periudhe të shtrirë kohore në vitin 2006, deri më 24.08.2007. Ky fakt nuk është deklaruar në deklaratat periodike të kohës, ndërkohë që akti i nënshkruar për të dokumentuar tjetërsimin e apartamentit mban datën 24.08.2007.

18.5. Më datë 4.11.2010, shoqëria “{***}” ShPK dhe porositësi [subjekti] kanë deklaruar revokimin e kontratës për këtë pasuri, me anë të një dokumenti noterial⁵⁹. Nisur nga fakti që në këtë deklaratë noteriale të revokimit, subjekti shprehet se ka përfituar gjithë pagesën në nëntor 2010, deduktohet që marrja në dorëzim e apartamentit përpara kësaj date nuk kontestohet. Për këtë arsye, nuk kontestohet edhe pagesa e vlerës së plotë deri në atë datë, e konkretisht 41.000 euro, kësti i fundit i së cilës kushtëzohej nga marrja në dorëzim e apartamentit.

⁵⁸ Datë 26.06.2006.

⁵⁹ Dokumenti noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 4.11.2010.

18.6. Po ashtu, referuar kontratës së sipërmarrjes, brenda vitit 2006, subjekti ka marrë përsipër pagesën e vlerës së kështit të dytë, prej 10.000 eurosh, brenda datës 25.09.2006. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nuk gjen mbështetje në akte dhe është jobindës pretendimi i subjektit pasi u njoh me rezultatin negativ financiar për vitin 2006 nëpërmjet rezultateve të hetimit se pagesat kanë ndjekur një kalendar tjetër, të ndryshëm nga kontrata e sipërmarrjes dhe që tenton të shtrijë pagesat në një hark kohor trevjeçar, sipas mandatpagesave të paraqitura prej tij bashkëngjitur deklaratës së pasurisë për rivlerësimin⁶⁰. Ky konkluzion mban në konsideratë disa faktorë.

18.7. Së pari, trupi gjykues sjell në vëmendje sa është parashtruar më sipër për faktin që subjekti ka porositur dy apartamente, por ka deklaruar vetëm njërin në kohë, ndërsa tjetrin vetëm pasi kishte shitur të parin. Për këtë arsye, edhe deklarimi i tij, i zhvendosur në vitin 2007 për pagesën e 25.000 eurove, ndërkohë që flitej për pasuri të kontraktuar e të paguar në një vlerë të konsiderueshme që në vitin 2006, qoftë prej 25.000 eurosh apo prej 35.000 eurosh, paraqitet si përpjekje për të përkulur faktet në një variant favorizues për subjektin, qoftë në deklaratën periodike të kohës, qoftë në procesin e rivlerësimit.

18.8. Së dyti, mandatpagesat përmbajnë probleme nga ana formale. Mandatpagesave u mungon numri serial dhe njëres prej tyre edhe data dhe vula e shoqërisë. Nën dritën e sa është shtjelluar më sipër, këto akte paraqiten në mospërputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet që normojnë kontabilitetin. Së treti, edhe nga ana përmbajtësore, përpos mospërputhjes me kontratat, rezulton një mospërputhje mes mënyrës sesi subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar ndarjen e pagesave dhe akteve. Ndërsa subjekti ka pretenduar në pyetësorë se pagesa e fundit në korrik 2010, ka qenë 5.000 euro, por nuk disponon mandatin, në dokumentacionin e dërguar në ILDKPKI, ai ka paraqitur një mandatpagesë me nr. {***}, datë 17.07.2010, në vlerën 3.000 euro, i nënshkruar, por i pavulosur. Për të gjitha këto problematika të konstatuara, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit që në analizën financiare të vitit 2006 të përfshijë pagesën sipas kontratës, në vlerën 35.000 euro, është i drejtë.

18.9. Subjekti ka pretenduar se një pjesë e pagesave janë mbuluar nga diferenca e mbetur nga kredia e marrë në vitin 2006. Gjatë procesit të hetimit administrativ, në pyetësorë, subjekti ka pretenduar se kredia nuk është përdorur për mobilim, pavarësisht ofertës paraprake dhe qëllimit fillestar, por u përdor për të shlyer pagesën e kësteve të kontratës së sipërmarrjes⁶¹. Ndërsa, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti ka potencuar se kredia është përdorur për shpenzime të ndryshme familjare, si dhe pagesë këstesh për apartamentin në Golem. Tërheqjet

⁶⁰ Subjekti ka bashkëngjitur tri mandatarkëtime: (i) nr. {***}, pa numër serie, datë 03.06.2008, në shumën 3.000 euro, përshkrimi: “Këst për blerje ap. në Golem”, firmosur nga financieri i shoqërisë dhe vulosur me vulën e shoqërisë, firmosur nga subjekti; (ii) nr. {***}, pa numër serie, datë 15.07.2008, në shumën 3.000 euro, përshkrimi: “Këst për blerje ap. në Golem”, firmosur nga financieri i shoqërisë dhe vulosur me vulën e shoqërisë, nuk është firmosur nga subjekti; (iii) nr. {***}, pa numër serie dhe pa datë, në shumën 5.000 euro, me përshkrim: “Këst për blerje ap. në Golem”, firmosur nga financieri i shoqërisë dhe nga subjekti, por i pavulosur. Në pyetësorin nr. 2, subjekti është shprehur se nuk disponon mandatpagesën e fundit prej 5.000 eurosh përpara revokimit të kontratës në 2010.

⁶¹ Përgjigjet e pyetësorit numër 3.

në *cash* nga llogaria e bashkëshortes, të shtrira në kohë e në vlera të ndryshme⁶², janë provë e faktit që kredia nuk u përdor për mobilim.

18.10. Trupi gjykues e vlerëson të bazuar edhe konkluzionin e Komisionit se kredia e mobilimit, me vlerë 1.500.000 lekë, nuk mund të shërbente si burim për pagesat për këtë pasuri. Nga analiza e akteve dhe pretendimeve të mësipërme të subjektit, rezulton se kredia nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e kësteve duke pasur parasysh disa rrethana.

18.11. Së pari, është fakt i pakontestueshëm që rezulton edhe nga përmbajtja e kontratës së kredisë, që qëllimi i deklaruar i kërimit të kësaj kredie, ishte mobilimi⁶³. Bashkëlidhur dokumenteve, kredimarrësit kanë vendosur një ofertë nga mobilieri “{***}” që mban datën 19.01.2006, të nënshkruar nga administratori i kompanisë ofertuese dhe analisti i kredisë, me kliente bashkëshorten e subjektit. Trupi gjykues vëren se subjekti nuk arriti të provonte që asnjë nga këto akte e veprime nuk ka prodhuar efektin e synuar në realitet, parë nga disa këndvështrime. Barra siguroese mbi kolateralin janë pikërisht mobiliet, mallrat e arredimit dhe aksesoret në vlerë të njëjtë me kredinë, nënshkruar edhe nga analisti i kredisë i bankës. Me fjalë të tjera, nga këto akte rezulton që kredimarrësit ishin të angazhuar për të kryer veprimet juridike të marra përsipër prej tyre, për të cilat u nevojitej kredia. Në referim të udhëzuesit të Bankës së Shqipërisë⁶⁴, nëpërmjet kontratës/marrëveshjes së kredisë për individin, kredidhënia nga një institucion financiar mund t’i shërbejë një game të gjerë transaksionesh financiare, siç janë blerja ose rikonstruksioni i një shtëpie, blerja e një automjeti apo konsumimi i të hollave për qëllime që individi i ka gjykuar të nevojshme. Duke pasur parasysh që subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshortja nuk kishin asnjë pengesë të referonin pagesat e apartamentit për të përfituar kredinë, nuk ka ndonjë arsye logjike të kërkohej kredia, përveç asaj të përcaktuar në mënyrë të shprehur si qëllim në kontratën e kredisë⁶⁵. Fakti që banka nuk ka kryer veprime në Regjistrin e Barrëve Siguroese, nënkupton se ajo duhet të jetë lëvruar sipas kushteve të kontratës⁶⁶. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson pa peshë provuese shkresën nga subjekti tregtar i përfshirë në shitjen e mobilieve për të provuar që kredia nuk është përdorur për qëllimin e marrë⁶⁷.

18.12. Së dyti, rezulton se kredia është disbursuar më datë 25.01.2006 në llogarinë rrjedhëse të personit të lidhur/bashkëshortes, ndërsa kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, që ka krijuar detyrimin e subjektit në vlerën 41.000 euro, është nënshkruar më datë

⁶² Kredia prej 1.500.000 lekësh është disbursuar në datën 25.01.2006. Përgjatë vitit 2006, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr në *cash* vlerat si më poshtë: (i) në datën 13.02.2006, vlerën 500.000 lekë; (ii) në datën 02.06.2006, vlerën 500.000 lekë; (iii) në datën 30.06.2006, vlerën 100.000 lekë; (iv) në datën 11.07.2006, vlerën 195.000 lekë; dhe (v) në datën 19.07.2006, vlerën 200.000 lekë. Në total është tërhequr *cash* vlera 1.495.000 lekë.

⁶³ Barrë siguroese mbi kolateralin janë vendosur mobiliet në vlerë totale prej 1.500.000 lekësh.

⁶⁴ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Udhezues_per_marredheniet_e_kredise/

⁶⁵ Neni 1 i kontratës përcakton si kusht paraprak përdorimin e kredisë vetëm për qëllimin e përmendur nga palët.

⁶⁶ Vërtetimi, datë 28.10.2019, nga Regjistri i Barrëve Siguroese pranë Ministrisë së Drejtësisë që konfirmon se nuk ka barrë siguroese në emër të bashkëshortes së subjektit.

⁶⁷ Vërtetimi nga {***} ShPK, datë 26.05.2020, sipas të cilit rezulton që subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë qenë klientë të asaj shoqërie për artikuj mobilierie.

27.06.2006. Kronologjia e tërheqjeve të shumës së kredisë në *cash* nuk përputhet me pagesat e apartamentit. Tërheqja e parë dhe e dytë, që përbëjnë edhe vlerat më të larta të tërhequra, 1.000.000 lekë në total, kanë ndodhur përpara se të hartohet kontrata e sipërmarrjes [datë 27.06.2006]. Së treti, kredia është disbursuar në llogarinë e pagës së personit të lidhur, gjë që pamundëson verifikimin e pretendimeve të subjektit për përdorimin e kredisë kundrejt pagës në shpenzimet e kryera. Për më tepër, përveç pagesave për këstet e kredisë, nga kjo llogari evidentohen edhe pagesa faturash të tjera. Në kushtet kur mandatarkëtimet nuk përputhen me përmbajtjen e kontratës së sipërmarrjes, Kolegji çmon se ato nuk përbëjnë provë bindëse që vërteton kryerjen e pagesave në një kalendar të ndryshëm nga kontrata e sipërmarrjes, edhe duke abstraguuar nga mungesa e kërkesave të formës së tyre. Së fundmi, subjekti ka deklaruar pagesën e shumës prej 25.000 eurosh brenda vitit 2006, ndërkohë që kredia ishte për një vlerë shumë të ndryshme, 1.500.000 lekë, fakt që edhe teorikisht e bën të pamjaftueshme kredinë e mobilimit për të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të vlerës së apartamentit. Për gjithë këto arsye, Kolegji konstatoi se konkluzioni i Komisionit se kredia nuk mund të ketë shërbyer si burim për prenotimin e këtij apartamenti, është i drejtë dhe pretendimi i subjektit i pambështetur në ligj e prova.

18.13. Kolegji rishikoi analizën financiare të Komisionit, në zbatim të sa është arsyetuar, dhe duke marrë në konsideratë dy zëra të shpenzimeve sipas pretendimeve të subjektit, e konkretisht, lidhur me shpenzime të përlllogaritura për shkak të kursit të këmbimit [monedha ALL në USD/Euro], si dhe zbriti një vlerë shpenzimesh telefonike për periudhën nëntor 2005 – tetor 2006, të cilat ai i ka paguar në emër të një individi tjetër, duke përlllogaritur shpenzimet në vlerën e specifikuar prej tij. Pas pasqyrimit të ndryshimeve të mësipërme, për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative prej 4.141.414 lekësh për të justifikuar krijimin e pasurive të paluajtshme dhe shpenzimet e tjera gjatë vitit 2006, situatë e parashikuar nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

VI. Automjeti “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2005

- 19.** Në analizën e kryer për pasuritë e krijuara në vitin 2005, Komisioni ka konstatuar nga hetimi administrativ, blerjen e një automjeti [markë “Mercedes Benz”] në vlerën prej 4.500 eurosh, sikurse edhe shpenzimet doganore, në totalin prej 958.071 lekësh. Ky automjet është shitur në vitin 2011, në çmimin 8.000 euro. Në konkluzion, në kushtet që Komisioni ka vlerësuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme edhe për krijimin e pasurive për vitin 2005 – arsyetuar më sipër në pjesën III dhe IV, edhe krijimi i kësaj pasurie afekton balancën negative të konstatuar për vitin 2005.

19.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pagesa e automjetit dhe taksa doganore janë kryer në vitin 2004, dhe duhet të reflektohen në analizën e këtij viti. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti potencon faktin e deklarimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike për vitin 2004, dhe fotografi të targës provizore të lëshuar nga autoritetet e vendit të blerjes [Gjermani] dhe fotografi pushimesh familjare në vitin 2004, në të cilat evidentohet automjeti. Sipas subjektit, në vitin 2005 ka ndodhur regjistrimi në institucionet përkatëse [Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor], në funksion të kalimit të pronësisë në emër të subjektit.

19.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri, është i drejtë. Të gjitha aktet zyrtare që dokumentojnë pronësinë e përdorimin e automjetit nga subjekti, i përkasin periudhës qershor-korrik 2005, e konkretisht: (i) kontrata e shitjes është nënshkruar më datë 26.06.2005; (ii) leja e qarkullimit në emër të subjektit të rivlerësimit mban datën 14.07.2005; dhe (iii) deklarata doganore është e datës 09.07.2005. Në kushtet kur subjekti nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion ligjor që të provojë se shpenzimet për këtë automjet janë bërë në vitin 2004, ndërsa gjithë veprimet juridike të gjurmueshme datojnë nga viti 2005, pretendimi i subjektit për zhvendosje të pjesshme të shpenzimeve në vitin 2004, pavarësisht nga data e akteve në fashikull, çmohet i pabazuar.

19.3. Trupi gjykues i Kolegjit i gjeti pa peshë provuese aktet e sjella nga subjekti për të provuar posedimin e mjetit që në vitin 2004 dhe, për rrjedhojë, edhe përlllogaritjen e peshës financiare të transaksionit në atë vit, pasi pretendimet se shpenzimet janë kryer një vit më pas për shkak të dokumentacionit, bien ndesh me dokumentacionin dhe janë të pabazuara. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se alternativa e potencuar nga subjekti – se ka përdorur një automjet për të cilin nuk kishte autorizim dhe asnjë titull pronësie për thujse një vit, në rrethana të cilat ai ka zgjedhur të mos i sqarojë në procesin e rivlerësimit, është e paprovuar prej tij dhe e pashpjeguar, përpos e pakuptimtë për një magjistrat që ka për detyrë zbatimin e ligjit. Pavarësisht, e duke abstraguuar nga këta faktorë, trupi gjykues thekson që kjo alternativë, edhe nëse do të pranohej teorikisht, nuk do ta përmbyste situatën financiare për vitin 2005.

19.4. Në përmbledhje të shkaqeve të sipërcituara të ankimit, të cilat afektojnë analizën financiare të vitit 2005, Kolegji kreu kontrollin e analizës së Komisionit. Si rrjedhojë e kësaj analize, balanca negative e konstatuar në kontrollin e kryer në Kolegji, ulet në mënyrë të papërfillshme, prej (-) 9.747.900 lekësh në (-) 9.739.433 lekë⁶⁸. Në përfundim, për vitin 2005, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

VII. Automjeti në bashkëpronësi, blerë në vitin 2011

- 20.** Pas hetimit administrativ, Komisioni konkludoi se ky automjet është pronësi e subjektit, ndërsa bashkëpronësia në ½ nuk u provua në kushtet kur nuk provohet që bashkëpronarja të ketë paguar ndonjë vlerë monetare në krijimin e kësaj pasurie. Për rrjedhojë, Komisioni ngarkoi të gjithë vlerën e blerjes së automjetit, 55.000 USD, në analizën financiare për vitin përkatës, 2011. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative prej (-) 1.739.153 lekësh për të krijuar këtë pasuri dhe shpenzimet e tjera, për gjithë vitin.

⁶⁸ *Ndryshimi përftohet për shkak të përlllogaritjes së pagës së përfituar nga personi i lidhur/bashkëshortja, nga sigurimet, sipas konfirmës bankare – 229.107 lekë përkundër 196.535 lekë.*

20.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është bashkëpronar dhe, si rrjedhojë, duhet të përllorarit vetëm 50% e vlerës së automjetit në ngarkim të tij, e konkretisht 27.500 USD, që ka si burim të ardhurat e fituara prej tij nga lotaria në ShBA në vitin 2005. Automjetin ka rënë dakord të blihet për 45.000 USD nga vëllai i bashkëpronares. Subjekti pretendon se ka dërguar gjithë shumën nëpërmjet transfertës bankare [në llogarinë e një familjareje të bashkëpronares], pasi gjysma e fondeve do të sillej *cash* në Shqipëri. Duke qenë se banka nuk e pranoi kryerjen e kësaj transferte, u dakordësua me bashkëpronaren që ta paguante ai të plotë të gjithë shumën, deri në ardhjen e saj në Shqipëri, kur ajo do të likuidonte pjesën e saj. Transferta e kryer pa sukses konfirmon këtë version faktesh, sipas subjektit. Së fundmi, subjekti shprehet se nuk ka deklaruar huanë apo detyrimet e pritshme nga bashkëpronarja në deklaratën periodike të vitit 2011, pasi shuma 15.000 USD u shlye prej saj po brenda vitit 2011.

20.2. Pasi analizoi aktet në fashikull, përfshirë aktet e administruara nga Komisioni⁶⁹ gjatë hetimit administrativ dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, trupi gjykues i Kolegjit çmon se konkluzioni i Komisionit për të përfshirë në analizën financiare të vitit 2011, të gjithë vlerën e automjetit objekt shqyrtimi, është i drejtë dhe i bazuar në prova. Subjekti ka paguar nga llogaria e tij bankare në ShBA, krijuar me të ardhurat nga lotaria, vlerën prej 45.668 USD, sikurse edhe 5.000 USD për këtë automjet, ndërsa nuk ka provuar asnjë pagesë nga bashkëpronarja, familjare e subjektit të rivlerësimit. Nga aktet, rezulton se në kushtet që bashkëpronarja nuk ka as mundësi praktike të përdorë mjetin në proporcion me pjesën takuese, investimi prej saj me 50% në automjet, edhe teorikisht gjendet jobindës. Arsyetimi i detajuar i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

20.3. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e në pjesë takuese prej ½ të këtij automjeti [“Mercedes Benz”], me vlerë 55.000 USD, në deklaratën periodike të vitit 2011. Subjekti nuk ka deklaruar burim për krijimin e pasurisë në këtë deklaratë. Burimi i krijimit është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin në pjesën konfidenciale, duke referuar të ardhurat nga lotaria në ShBA në vitin 2005. Po aty, subjekti ka deklaruar pjesën takuese në vlerën 27.500 USD. Po ashtu, nga aktet⁷⁰, rezulton që automjeti është eksportuar nga porti i New York-ut në prill 2011. Nga aktet në fashikull, nuk specifikohet data e hyrjes.

20.4. Komisioni ka prezumuar si kohë hyrje të përafërt në Shqipëri duke nisur nga eksportimi, një periudhë kohore të vitit 2011, pas muajit prill. Veprimet për zhdoganimin janë kryer vetëm tre (3) vjet më pas nga subjekti i rivlerësimit. Në datën 15.02.2011, subjekti i ka paguar kompanisë shitëse në Wisconsin (ShBA), nga llogaria e tij bankare po ashtu në ShBA, një vlerë që përbën 84% të çmimit të mjetit, 45.668 USD. Më datë 09.03.2011, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka kryer një transfertë bankare në shumën 5.000 USD në favor të një individi tjetër që, sipas subjektit, është vëllai i bashkëpronares. Në total, nga aktet, dokumentohet pagesa e vlerës prej 50.668 USD nga subjekti.

⁶⁹ Shkresat me nr. {***} prot., datë 30.1.2019 dhe nr. {***} prot., datë 7.2.2019 – DPShTRr ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Gaxha, dhe znj. A. G. kanë në pronësi automjetin me targë {***}.

⁷⁰ Dosja përcjellë Komisionit nga DPShTRr.

20.5. Nga ana tjetër, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se e afërmja e subjektit që deklarohet prej tij në cilësinë e bashkëpronares, ka hyrë në Shqipëri më 04.03.2011, pak ditë *përpara* transfertës së fundit bankare për këtë automjet në emër të vëllait të saj dhe pak kohë pas blerjes së mjetit nga subjekti në shkurt 2011. Në analizë të harkut kohor në fjalë, Komisioni ka konstatuar se bashkëpronarja ka pasur mundësi teorike të përdorë automjetin vetëm dy herë gjatë vizitave të saj në Shqipëri. Nga ana tjetër, Komisioni ka konstatuar se në kushtet që bashkëpronarja ishte në Shqipëri duke nisur nga data 04.03.2011, janë jobindëse shpjegimet e subjektit për arsyen e pagesës prej tij të vlerës 5.000 USD disa ditë më pas, sikurse edhe shpjegimet për pagesat që ajo i shleu në mars dhe korrik 2011 në *cash*, për 15.000 USD dhe 8.000 të tjera në vitin 2013.

20.6. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit se konkluzioni i Komisionit është i drejtë, bazohet në disa hapa të ndjekur gjatë analizës. Duke abstraguuar nga mospërputhjet në vlerën e deklaruar ndër vite dhe sipas akteve për automjetin, kundrejt vlerës që argumenton në ankim – konkretisht, 55.000 USD kundrejt 45.000 USD⁷¹ – subjekti i rivlerësimit është jobindës për faktin që automjeti objekt analize përbën një investim në të cilin ai ka kryer vetëm 50% të shpenzimeve, ashtu edhe për sa u përket shpjegimeve që lidhen me arsyet dhe mënyrën e pagesës së pjesës takuese nga e afërmja e tij. Më konkretisht, subjekti nuk arriti të japë shpjegime të arsyeshme për logjikën ekonomike të shpenzimeve të konsiderueshme me të cilat shoqërohet blerja dhe eksportimi nga ShBA për në Shqipëri i një automjeti të cilin edhe teorikisht, bashkëpronarja mund ta përdorte vetëm *dy/tri herë* në harkun kohor 2011-2013 – siç rezulton nga hetimi i kryer nga Komisioni apo nga shpjegimet e subjektit⁷².

20.7. Po ashtu, trupi gjykues vëren që, pavarësisht se nga aktet në fashikull automjeti ka qenë në bashkëpronësi formalisht, subjekti nuk arriti të shpjegojë përse nuk ka asnjë gjurmë dokumentare të ndonjë pagese, qoftë edhe të pjesshme të bashkëpronares. Përkundrazi, gjithë pagesat janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, dhe asnjë transaksion në emër të bashkëpronares, por në emër të të afërmeve të saj, përkatësisht vëllait dhe një transfertë [e pasuksesshme] në emër të nënës së saj. Sjellim në vëmendje që e afërmja/bashkëpronarja ishte me qëndrim në ShBA dhe, për pasojë, lehtësisht në gjendje të kontribuonte pjesën e saj të shpenzimeve. Për këtë arsye, janë të pakuptimta arsyet e potencuara nga subjekti për nevojën e pagesës së 100% të vlerës së mjetit [apo 84% sipas kostos së deklaruar prej tij në deklaratimet e pasurisë], në kushtet kur e kundërta – pagesa e gjithë vlerës prej bashkëpronares kundrejt pagesës së mëvonshme – do të ishte një rrethanë faktike hipotetike më e pritshme, sikurse edhe pagesa e secilit prej bashkëpronarëve.

⁷¹ Subjekti pretendon që në fakt e ka deklaruar automjetin 10.000 USD më shumë sesa vlera e rënë dakord në kontratën e shitjes. Në fashikull nuk rezulton një akt që të provojë shitjen, përpos transfertës bankare të kryer nga subjekti më 15.02.2011, për 45.668 USD.

⁷² Nga kontrolli i bazës së të dhënave të Policisë së Shtetit në pikat e kalimit kufitar, TIMS, kryer nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për hyrjet e znj. A. G. në Republikën e Shqipërisë, si dhe nga përgjigjet e subjektit në pyetësorin nr. 4. Shih vendimin e Komisionit, faqe 43 dhe 44.

20.8. Pretendimi i subjektit për “nevojën për të aksesuar” fondet e tij në llogarinë bankare të tij në ShBA [krijuar në saje të lotarisë në vitin 2005], bie ndesh me faktin që në fakt, më 15.02.2011, subjekti ka aksesuar këto fonde lehtësisht. Për këto arsye, edhe shpjegimi i tij për arsyet e kryerjes së transaksionit bankar për të njëjtën vlerë në drejtim të nënës së bashkëpronares⁷³, rezulton pa vlerë provuese. Përkundrazi, në kushtet që edhe ai transaksion ka qenë për një vlerë shumë të përafërt me atë të paguar në pikën fundore nga subjekti, 49.500 USD kundrejt 50.668 USD⁷⁴, ky detaj konfirmon që subjekti në të dyja rastet ka paguar të gjithë vlerën e mjetit, si dhe që “aksesimi” i fondeve në llogarinë bankare në ShBA nuk ka qenë problematik. Për këtë arsye, edhe parë nga këto këndvështrime, kërkimi i metodave alternative për të aksesuar fondet, nëpërmjet bashkëpronares, rezulton një shpjegim jobindës. Së fundmi, pagesa e kryer në mars 2011 në drejtim të të afërmit tjetër, vëllait të bashkëpronares, në vlerën 5.000 USD nga llogaria bankare në Shqipëri⁷⁵, konfirmon më tej faktin që pronësia e subjektit mbi këtë pasuri nuk mund të ishte e pjesshme. Nëse kjo pagesë kryhej për shpenzime administrative, nuk duket e logjikshme që subjekti të vijonte të shtonte shpenzimet e kryera prej tij, ndërkohë që bashkëpronarja i detyrohej me ½ e vlerës së mjetit.

20.9. Në kushtet kur nga dokumentacioni nuk provohet asnjë pagesë, qoftë edhe e pjesshme, e pjesës takuese të vlerës së automjetit, paguar nga e afërmja e subjektit si bashkëpronare, sikurse edhe arsye bindëse për të shpjeguar rrethanat e blerjes sipas shpjegimeve të subjektit, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare të vitit 2011, të gjithë vlerën e automjetit objekt shqyrtimi. Për sa më lart, në Kolegji, ashtu si në Komision, analiza financiare për vitin 2011 u krye duke përfshirë vlerën e plotë të automjetit. Pas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.542.770 lekë për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2011, parashikuar nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

VIII. Automjeti “Toyota Rav 4”

- 21.** Krahas analizës për apartamentin në Golem (shkaku V i ankimit më sipër), në vendim, Komisioni ka arsyetuar nën një rubrikë të titulluar “Analiza financiare/Gjetje të tjera në DPV” për sa i përket automjetit objekt analize, të shitur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konkluduar se subjekti është munduar të fshehtë të drejtat reale mbi këtë automjet dhe zotërimin e tij. Komisioni e ka gjetur jobindës pretendimin e subjektit se automjeti ka qenë pronë e motrës së tij, targuar në emër të tij për efekt dokumentacioni. Përfundimisht, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme

⁷³ Nga të dhënat e llogarisë së krijuar nga lotaria në ShBA [City Gold] rezulton se në datën 11.02.2011, është transferuar në llogarinë bankare të znj. H. G. në një bankë brenda vendit (në ShBA) shuma 49.500 USD. Kjo shumë është kthyer brenda së njëjtës dite në llogarinë e dërguesit, subjektit të rivlerësimit.

⁷⁴ Më datë 15.2.2011, subjekti ka transferuar 45.666.08 USD në llogari të shitësit të automjetit. Transferta përmban përshkrimin: “{***}”.

⁷⁵ Transfertë në drejtim të z. L. G. më 09.03.2011, në vlerën 5.000 USD. Referuar edhe në paragrafin 20.5 më sipër.

për krijimin e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve të vitit 2008, në vlerën (-) 281.612 lekë.

21.1. Subjekti pretendon se automjeti, ndonëse në emër të tij, i përket të motrës dhe kërkon që analiza financiare e vitit 2008 të mos përfshijë shpenzimet për blerjen e këtij mjeti, konkretisht në vlerën 13.489 USD. Subjekti pretendon se transferta bankare e kryer nga personi i lidhur/bashkëshortja në vitin 2008, në këtë vlerë, në drejtim të bashkëjetuesit të motrës së subjektit të rivlerësimit, nuk përbën pagesë të automjetit, por kthim fondesh të investuara nga motra për një pasuri të paluajtshme. Sipas subjektit, e motra ka paguar një këst për një kontratë sipërmarrjeje me një shoqëri ndërtimi në Vlorë⁷⁶ dhe kjo transfertë ishte pjesë e revokimit të kësaj kontrate. Sipas subjektit, aktet⁷⁷ pasqyrojnë në mënyrë konsistente deri në vitin 2014, pronësinë e kumatit të subjektit, sikurse edhe pronësinë e motrës pasi bashkëjetuesi ka ndërruar jetë.

21.2. Nga analiza e akteve në fashikull, përkundër pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupit gjykues i Kolegjit konkludon që analiza e kryer nga Komisioni dhe vlerësimi përfundimtar, janë të drejtë. Subjekti i rivlerësimit ka poseduar këtë automjet në mënyrë të pandërprerë që nga viti 2008, e ka regjistruar në emër të tij në vitin 2014 dhe e ka shitur në vitin 2016. Në të gjithë këta hapa në kohë, subjekti është sjellë si pronar. Pretendimet e subjektit për shkaqet për të cilat ai ka blerë nga shitësi, importuar në Republikën e Shqipërisë, përdorur e regjistruar në emrin e tij, një automjet që nuk ishte pronë e tij, zhdoganuar gjashtë (6) vite pasi filloi përdorimi, e deklaruar vetëm në këtë moment kohor sipas ligjit nr. 9049/2003, janë alogjike dhe të pabazuara. Njësoj jobindëse janë shpjegimet e subjektit për arsyen e transfertës bankare të kryer nga personi i lidhur në adresë të shitësit, një person i afërt me subjektin. Në vijim shtjellohet analiza e trupit gjykues lidhur me këtë shkak ankimi.

21.3. Nga aktet në fashikull, rezultojnë veprimet kronologjike që vijojnë.

- a. Më datë 27.2.2008, personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit ka transferuar nga llogaria e saj bankare në Raiffeisen Bank, shumën 13.488.69 USD, me përfitues z. L. H..

⁷⁶ Nga shoqëria “{***}” ShPK.

⁷⁷ Subjekti referon si prova në mbështetje të pretendimeve të tij: (i) kontratën e blerjes së automjetit në ShBA nga z. L. H.; (ii) certifikatën e pronësisë së automjetit të datës 17.03.2008; (iii) kontratën noteriale të huapërdorjes, datë 29.12.2010, të përpiluar nga huadhënësi; (iv) kartonin e regjistrimit të automjetit në Illinois (ShBA) për vitin 2010, ku referohet si pronar i mjetit z. L. H.. Kjo, sipas tij, vërteton që vlerësimi i Komisionit se më datë 17.03.2008, është kryer kalimi i pronësisë nga L. H. te subjekti i rivlerësimit, është i gabuar; (v) deklaratën doganore të datës 29.08.2014, e cila vërteton pronësinë e automjetit, ka kaluar nga z. L. H. te motra e subjektit, nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë; (vi) shkresën e datës 23.03.2016 - DPD drejtuar DPSHTRR Tiranë, nëpërmjet së cilës, znj. L. G. evidentohet si debitore në listën e debitorëve të automjeteve, për muajin janar 2016; (vii) faturën për arkëtim të datës 24.06.2016, të lëshuar nga Dogana Durrës, e cila përcakton si debitore pronaren e automjetit L. G.; (viii) vërtetimin e datës 20.11.2020, të shoqërisë “{***}” ShA, sipas të cilit, në emër të subjektit, janë lëshuar polica sigurimi me përdorues z. Artur Gaxha, dhe vetëm në rastin e përmendur nga Komisioni, është shkruar gabimisht prej lëshuesit të kartonit se subjekti është pronar i automjetit. Sipas tij, Komisioni ka evidentuar të vetmin rast ku subjekti rezulton si pronar dhe nuk ka përmendur të gjitha rastet e tjera ku ka rezultuar si përdorues; (ix) deklaratën noteriale, datë 24.11.2020, të motrës së subjektit.

- b. Më 29.2.2008 (sipas faturës së shitjes), z. L. H. ka blerë automjetin “Toyota Rav 4” në ShBA, në vlerën 31.650 USD.
- c. Në certifikatën e titullit, lëshuar më datë 17.3.2008, te firma e shitësit ka firmosur L. H., ndërsa te firma e blerësit është shënuar emri i subjektit, *Artur Gaxha*.
- ç. Më datë 16.4.2008, ky automjet ka dalë për eksport jashtë territorit të ShBA-së.
- d. Më datë 15.6.2008, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në territorin e Republikës së Shqipërisë automjetin, nëpërmjet pikës së kalimit të kufirit të Hanit të Hotit⁷⁸.
- dh. Subjekti nuk ka deklaruar asnjë nga veprimet e mësipërme në deklaratën periodike të vitit 2008, apo në ato në vijim. Në deklaratën për vitin 2014, subjekti e ka deklaruar automjetin si pronë e motrës, “targuar për efekt dokumentacioni” në emrin e tij.
- e. Në prapësim të rezultateve të hetimit, subjekti ka sjellë një kontratë huapërdorjeje që mban datën 29.12.2010, sipas së cilës kunati i jepte këtë automjet në huapërdorje. Nga baza e të dhënave të Policisë Kufitare të Shtetit [TIMS], deklaruesi nuk ka qenë në Shqipëri ditën kur është hartuar kjo deklaratë, duke qenë evidentuar të ketë dalë në datën 18.10.2010 dhe kthyer vetëm në korrik 2011.

21.4. Nga sa më sipër, rezulton që automjeti është blerë dy ditë pas një transferte të shumës 13.488 USD nga personi i lidhur me subjektin/bashkëshortja. Në vijim, pas përreth dy javësh, automjeti referohet i shitur te subjekti në një akt zyrtar të shtetit të Illinois-it dhe është eksportuar nga ShBA, në prill 2008. Në qershor 2008, subjekti e ka importuar automjetin në Shqipëri dhe vijuar me përdorimin e tij. Në vitin 2014, pas gjashtë (6) vitesh përdorimi, automjeti i është nënshtruar procedurës doganore në Republikën e Shqipërisë. Rrethanat që kanë kontribuar në kryerjen e procesit të zhdoganimit e regjistrimit pas gjashtë (6) vitesh, nuk janë hetuar nga Komisioni, sikurse edhe as shpjeguar nga subjekti. Duke abstraguuar nga ky fakt, trupi gjykues vëren se mbeten deklarative e jobindëse shpjegimet e subjektit përse në aktet zyrtare identifikohet ai si blerës e më pas si pronar i mjetit në Shqipëri. Aktet zyrtare të lëshuara nga shteti i Illinois-it, sikurse edhe ato të hartuara nga institucionet shqiptare, me përjashtim të deklaramit doganor, mbajnë emrin e subjektit në cilësinë e blerësit. Konkretisht, leja e qarkullimit dhe siguracioni i automjetit dhe aktet doganore – që datojnë në shtator 2014 – janë të gjitha në emër të subjektit. Në këtë kontekst, nëse arsyeja për të cilën veprimet fillestare identifikojnë subjektin si blerës për shkak të mungesës së dokumentacionit identifikues të motrës nga autoritetet në Shqipëri, kjo arsye nuk mund të gjejë zbatim ende edhe në vitin 2014, kur subjekti rezulton pronar. Sjellim në vëmendje që sipas subjektit, duke nisur nga viti 2011, motra dhe bashkëshorti ishin kthyer në Shqipëri⁷⁹.

21.5. Kolegji e çmon të drejtë konkluzionin e Komisionit se në kushtet kur ky automjet ka hyrë në Shqipëri që në vitin 2008, procedura e zhdoganimit të tij është bërë mbi bazën e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti apo familjarët e tij. Nga ana tjetër, deklarata noteriale e motrës së subjektit ka vlerë të kufizuar provuese për shkak të kohës kur është hartuar dhe

⁷⁸ Shkresat e DPShTRr nr. {***} prot., datë 30.1.2019, dhe nr. {***} prot., datë 7.2.2019. DPShTRr-ja ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin “Toyota Rav4”, i cili është blerë në datën 29.2.2008, në ShBA, nga z. L. H., dhe në datën 17.3.2008 është bërë transferimi/shitja te subjekti i rivlerësimit.

⁷⁹ Sipas prapësimeve të subjektit pas rezultateve të hetimit dhe në ankim.

pasi përmbajtja është kontradiktore me aktet zyrtare. Konkretisht, deklaratatë noteriale është hartuar pasi subjekti u njoh me vendimin e Komisionit, paraqitet si një përpjekje për të mbështetur versionin e fakteve të pretenduara nga subjekti – vendimi objekt ankimi është shpallur në shtator 2020, ndërsa deklarata është hartuar në nëntor 2020. Po ashtu, për shkak të natyrës konceptuale të saj, deklarata noteriale nuk mund të përmbysë vlerën provuese të veprimeve që rezultojnë nga aktet zyrtare të kohës.

21.6. Kolegji e çmon me vlerë të kufizuar provuese edhe deklaratën noteriale të huapërdorjes së automjetit për subjektin në vitin 2010. Kjo deklaratë, ndonëse një dokument i hartuar përpara procesit të rivlerësimit, shkon në linjë me gjithë hapat e ndjekur nga subjekti për përdorimin e mjetit, pa e regjistruar në Shqipëri për një periudhë kohore të konsiderueshme – gjatë vjet – sikurse edhe me mosdeklarimin e marrëdhënies së tij me këtë mjet sipas ligjit nr. 9049/2003. Fakti që sipas të dhënave zyrtare, deklaruesi nuk ndodhej në Shqipëri, përforcon analizën e mësipërme të nevojës së përdorimit të mjetit nga subjekti. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit thekson se edhe nëse pranohet argumenti i subjektit që emri i tij në titullin e automjetit, nuk përbën akt shitjeje – në kushtet kur ai nuk ishte fizikisht në ShBA, në mars 2008 – fakti që edhe në vitin 2014, edhe në Shqipëri, dokumentacioni për regjistrimin e automjetit sërish është hartuar dhe mban emrin e tij, tregon që ky automjet ka qenë në fakt pronë e subjektit. Për gjithë këto arsye, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit për sa i përket fiktivitetit të kontratës së huapërdorjes, sikurse edhe analizës së kryer mbi bazën e të dhënave të marra gjatë hetimit administrativ për policën e sigurimit e të dhënave të tjera nga faqja zyrtare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që i përkasin periudhës përpara regjistrimit të mjetit në Shqipëri.

21.7. Së fundmi, ndonëse në vendimin e Komisionit mungon analiza, trupi gjykues i Kolegjit e konstaton të drejtë mospranimin nga Komisioni të shpjegimeve të subjektit për shumën 13.500 USD, dërguar nga personi i lidhur/bashkëshortja në adresë të kumatit, në shkurt 2008 [referuar në paragrafin 21.3/a]. Ky konkluzion i trupit gjykues të Kolegjit bazohet në disa aspekte të marra në analizë. Së pari, nga aktet në fashikuj, nuk ka asnjë gjurmë dokumentare që të provojë dhënien e kësaj vlere në *cash* subjektit nga shoqëria “{***}” ShPK, që pretendohet të jetë rimbursimi porositësve [motrës e kumatit të subjektit] për shkak të mosrespektimit të pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes. Së dyti, trupi gjykues vëren se dokumentacioni i sjellë nga subjekti ka probleme të anës formale: (i) kontrata e sipërmarrjes, që si dokument i thjeshtë/jonoterial, në drejtim të provueshmërisë, mbetet me vlerë të kufizuar provuese dhe merret me rezervë në vlerësimin tërësor të marrëdhënies juridike; (ii) mandatpagesave u mungon vula e shoqërisë sipërmarrëse, përveçse nuk ka asnjë të dhënë të gjurmueshme të pagesave të kryera nga porositësit apo të depozitimit të vlerave nga sipërmarrësi. Së treti, nga ana përmbajtësore, kontrata ka kontradikta dhe nuk paraqet besueshmëri, duke marrë në konsideratë edhe rrethanat faktike objekt analize. Konkretisht, sipas akteve të sjella, njoftimi për zgjidhjen e kontratës është bërë më datë 11.01.2007, nga shoqëria “{***}” ShPK, ndërsa transfertat bankare kumatit të subjektit është kryer 13 muaj më pas, më datë 27.02.2008. Për të gjitha këto mospërputhje, duke mbajtur në konsideratë faktin që (i) transfertat të kumatit të subjektit është pa përshkrim, që nënkupton se mungojnë edhe

rrethanat indirekte që të provojnë pretendimin se vlera përfaqëson këstin e apartamentit; dhe që (ii) kjo transfertë përkon me momentin e blerjes së automjetit, datë 29.02.2008, trupi gjykues vëren se edhe këto akte të sjella nga subjekti, dështojnë të zhbëjnë sa u konkludua më sipër për përpjekjet e subjektit për të fshehur marrëdhënien reale të tij me këtë pasuri.

21.8. Në vlerësimin tërësor të fakteve dhe rrethanave të cilat përbëjnë panoramën faktike dhe ligjore të kësaj marrëdhënieje pronësie, trupi gjykues konkludon se transfertat më datë 27.02.2008, në vlerën 13.488,69 USD, ka qenë në funksion të pagesave për këtë automjet. Pas kontrollit të analizës së Komisionit, Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme në vlerën (-) 264.653 lekë, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2008, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

IX. Për të ardhurat nga qiradhëniet

22. Gjatë verifikimit të deklaratave periodike të deklarimit të pasurive, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit për vitet 2011, 2013, 2014 dhe 2015, ka deklaruar të ardhura nga dhëniet me qira të ambienteve në pronësi/zotërim të tij dhe personit të lidhur. Këto të ardhura subjekti i ka vetëdeklaruar pranë organeve tatimore në deklaratën DIVA dhe ka paguar detyrimin tatimor. Rishikimin e pagesave të detyrimit tatimor mbi të ardhurat e përfituara, gjatë viteve 2017-2020, krahas deklarimit në deklaratat periodike, Komisioni e ka analizuar në drejtim të ndreqjes së gabimeve si rrjedhojë e rivlerësimit nga organi tatimor. Pas kësaj analize, Komisioni ka konkluduar të pasqyrohen të ardhurat e plota të përfituara nga qiraja për vitet përkatëse, të cilat janë deklaruar në deklaratat DIVA e depozituar edhe në ILDKPKI, referuar shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në vitin 2017. Pas kryerjes së analizës financiare, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen/krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera/investime të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2011.

22.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në referim të dy shkresave të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tiranë nr. {***} dhe nr. {***}, datë 14.07.2020, këto të ardhura për vitin 2013 dhe vitin 2015, janë më të larta se ato të pasqyruara nga Komisioni në analizën financiare të këtyre viteve. Ndaj, sipas tij, në Kolegji duhet të reflektohen këto ndryshime dhe të merren në konsideratë të ardhurat e përfituara sipas rishikimeve me shkresat nr. {***} dhe nr. {***}, datë 14.07.2020.

22.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi vendimin e Komisionit, vëren se për pagimin e tatimeve për të ardhurat nga qiradhëniet, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka dhënë përgjigje të ndryshme brenda harkut kohor 2017-2020. Konkretisht:
a. Në datën 28.7.2017 [shkresa nr. {***} prot.], në korrespondencë me ILDKPKI-në, ky institucion referon se për vitin 2013, të ardhurat nga qiraja janë ato të deklaruara në DIVA-n e vitit 2014, ndërsa të ardhurat e vitit 2015, janë ato të deklaruara në vitin 2017.

b. Në datën 26.9.2017 [shkresa nr. {***} prot.], drejtuar po ashtu ILDKPKI-së, referon se është kryer rivlerësimi i situatës “së deklaruar gabim”, me kërkesë të subjektit dhe personit të lidhur, “si efekt i pasqyrimin të pasaktë të shpenzimeve të zbritshme në deklaratat e periudhave 2011; 2012; 2013 dhe 2014”. Si rrjedhojë, janë pasqyruar të ardhurat e rishikuara në DIVA.

c. Në datën 05.03.2019 [me shkresën nr. {***} prot.], në korrespondencë me Komisionin, vlera e të ardhurave nga qiraja për vitet 2013 dhe 2015, është referuar e njëjtë me atë të shënuar në pikën e mësipërme.

ç. Në datën 14.07.2020, në korrespondencë me personin e lidhur me subjektin/bashkëshorten [me shkresën nr. {***} prot.], institucioni tatimor referon se për të ardhurat e vitit 2013, “ka pasur përsëri ndryshim të vlerës, deklaruar në DIVA-n e datës 26.07.2018”, për shkak të një auditimi.

22.3. Nga sa më sipër, rezultojnë dy shkresa përpara hetimit administrativ, ndërsa dy të tjera përkojnë me kohën kur ka nisur hetimi dhe pasi subjekti është njohur me rezultatet e hetimit administrativ [përkatësisht më 22.06.2020]⁸⁰. Pavarësisht nga rishikimet e përsëritura të të ardhurave të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur dhe duke abstraguar nga rëndësia e momentit kohor kur subjektit dhe personit të lidhur u është mundësuar ndryshimi në favor të analizës së tyre financiare, i vlerave në funksion të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që edhe duke pranuar vlerat që duket se përditësohen gjatë procesit, analiza financiare për vitet në fjalë *mbetet me balancë negative*. Po ashtu, meqenëse nga të dhënat e rishikuara të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, ndryshon vetëm vlera për vitin 2013, Kolegji kreu verifikimin e analizës edhe sipas shkresës së vitit 2020. Edhe pas kryerjes së kësaj analize, sipas kërkimeve në ankim, rezultoi se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, parashikuar nga germa “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

X. Kontrolli i analizës së Komisionit për vitin 2012

- 23.** Komisioni ka vlerësuar se përveç sa analizuar në secilën pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për vitet 2012 dhe 2013 pasi ka rezultuar me balancë negative të fondeve për të përballuar shpenzimet dhe investimet e deklaruara dhe evidentuara. Konkretisht, në analizën financiare për këto dy vite, Komisioni ka konstatuar mungesë burimesh në vlerën (-) 1.903.337 lekë për vitin 2012 dhe (-) 20.172.059 lekë në vitin 2013.

23.1. Subjekti ka kërkuar në ankim që të kryhen një sërë korrektimesh për vitin 2012. Sipas subjektit, me pasqyrimin e këtyre ndryshimeve, ai do të rezultojë me balancë negative më të vogël se sa ajo e konkluduar nga Komisioni. Konkretisht, subjekti kërkon: (i) të kryhet “sistemimi” i vlerës së të ardhurave nga interesat sipas konfirmës bankare; (ii) të përfshihet vlera e përfituar nga dëmshpërblimi i shëndetit dhe rimbursimi sipas faturës së aeroportit të Vjenës; (iii) të saktësohet vlera e shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit; (iv) të pasqyrohet pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2003, dhe gjendjet e deklaruara në vitet 2006 dhe 2007, të cilat janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave familjare; si dhe (v) të

⁸⁰ Referuar paragrafit 17 të vendimit të Komisionit.

kryhet saktësimi i gjendjes së likuiditetit në bankë sipas *statement*-it bankar. Për sa i përket vitit 2013, përpos përfshirjes së vlerave të rishikuara të qirave kërkuar nga subjekti, analiza financiare afektohet për shkak të pasurive të krijuara në vitin 2013, analizuar më sipër në shkakun II të ankimit.

23.2. Pa përsëritur sa është arsyetuar për vitin 2013, për sa i përket vitit 2012, edhe pas korrektiveve të kryera në funksion të kontrollit të analizës financiare të Komisionit, konkluzioni për mungesë burimesh të ligjshme qëndron. Balanca negative e konstatuar nga Komisioni reduktohet në vlerën (-) 1.756.515 lekë, pasi kryhen disa korrektive të kërkuara nga subjekti, të cilat trupi gjykues i gjeti të bazuara. Konkretisht, ndryshe nga Komisioni, Kolegji e vlerësoi të drejtë kërkesën e subjektit për të sistemuar vlerat e të ardhurave nga interesat bankarë dhe për të përfshirë të ardhurat nga dëmshpërblimi i shëndetit dhe rimbursimi nga aeroporti i Vjenës sipas vlerës së pasqyruar në *statement*-in bankar. Gjithashtu, Kolegji kreu edhe sistemimin e gjendjes së likuiditeteve në bankë, sipas *statement*-it bankar dhe jo sipas vlerës së pretenduar nga subjekti.

23.3. Kërkimet e tjera të subjektit u gjetën të pabazuara dhe, për rrjedhojë, pa ndikim në analizën financiare. Konkretisht, shpenzimet e dy udhëtimeve në Greqi nuk pësuan korrektime, nën dritën e faktit që subjekti ka deklaruar gjatë hetimit në Komision se ka qëndruar në hotel. Pretendimi i mëpasmë dhe në ankim se në fakt, ka qëndruar te vëllai i bashkëshortes dhe duhet të përlllogaritet udhëtimi duke e reduktuar me ekuivalentin e përreth 402 eurove [971.965 lekë përkundër 1.026.791 lekëve], bie ndesh me deklaratimet e subjektit në pyetësor dhe u gjet i pabazuar. Në të njëjtën mënyrë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të pabazuar edhe pretendimin se gjatë vitit 2012, subjekti ka përdorur pakësimin nga gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2003 dhe atë të deklaruar në vitet 2006 dhe 2007 për mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave familjare. Në kushtet që ky pretendim nuk gjen pasqyrim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, në të cilën subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, nën dritën e vlerës provuese të deklaratave periodike vjetore të subjekteve sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sikurse konfirmuar në jurisprudencën e Kolegjit, edhe ky pretendim u gjet i pabazuar. Së fundmi, nuk u përfshinë të ardhurat nga dy transaksione hyrëse në tetor dhe nëntor 2012, për të cilat mungon deklarimi i shpenzimit të cilit i korrespondojnë apo përshkrimi⁸¹, e që gjithsesi për shkak të vlerës së ulët, janë pa ndikim përcaktues në balancën negative të vitit.

- 24.** Në përmbledhje të sa më sipër, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e mungesës së konsiderueshme të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të kryera. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, në kontroll të vendimit të Komisionit, edhe nëse merren në konsideratë disa nga kërkimet e tij – analizuar gjerësisht më

⁸¹ Konkretisht, transaksioni i datës 31.10.2012, nga rimbursim nga TVSh-ja, në kushtet që shpenzimet për blerjet të cilave ato u korrespondojnë nuk janë përfshirë, deklaruar apo konfirmuar në asnjë formë, në totalin prej 571 eurosh. Transaksioni tjetër është një vlerë e përfituar nga personi i lidhur/bashkëshortja, në vlerën 374 euro, në datën 02.11.2012, për të cilin mungon përshkrimi apo shpjegime të dhëna nga subjekti.

sipër – sërish subjekti i rivlerësimit rezulton me një balancë negative për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve, në vlerën 43.483.300 lekë.

25. Bazuar në analizën dhe konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Artur Gaxha nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Për pasojë, nën dritën e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit pamjaftueshëm. Vendimi nr. 293, datë 10.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në germën “a” të pikës 1 të neni 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 293, datë 10.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Gaxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 08.06.2023.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi